



# DRITA ISLAME

Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / Çmimi: 250 Lekë / [www.dritaislame.al](http://www.dritaislame.al)

Viti XXXIV / Nr. 11 / Nëntor 2025



**35 VJET LIRI BESIMI**  
16 NËNTOR 1990 - 16 NËNTOR 2025



**“DRITA ISLAME”**

**Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë**

**www.dritaislame.al**

**DREJTOR**

**Dorian Demetja**

**KRYEREDAKTOR**

**Mehmet Disha**

**DIZAJNI DHE FAQOSJA**

**Erzen Carja**

**KONTAKT:**

**Tel/fax +355 68 87 71 655**

**E-mail: mehmet.disha@kmsb.al**


**Viti XXXIV i botimit**

**Nr. 11 (509)**


**Nëntor, 2025**

**ISSN 2226-7115**

*Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen, nuk  
paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.*



**www.dritaislame.al**



## editorial

**04** 35 Vjet liri besimi  
Dorian Demetja

## në fokus

**06** Roli i prijësve myslimanë në formimin e shtetit të parë shqiptar / Dr. Mojs Kamberi

## lajme / aktivitete

**10** 01-Xhamia "Ballie" në Elbasan mirëpret "frytet e besimit"  
02-Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë viziton panairin kombëtar të librit 2025  
03-Komunitetit Mysliman i Shqipërisë në ndihmë të fëmijëve talasemikë  
04-Vizitë pune në Myftininë e Lushnjes  
05-Medreseja e Tiranës zhvillon program festiv me rastin e 28-29 Nëntorit  
06-KMSHZ zhvillon simpoziumin shkencor ndërkombëtar

## refleksione

**16** Islami dhe Shkenca Moderne  
Ilhan Kutluer

## çështje fetare

**18** Dashuria dhe besnikëria ndaj Atdheut  
Redaksia

## familja

**20** Dhuna në familje dhe qëndrimi i Islamit ndaj këtij fenomeni  
Ana Haxhiu

## horizonti i besimit

**22** 28 Nëntor 1912  
Faik Konica  
**24** Kujtime nga rihapja e lirisë së besimit në Shqipëri  
Hadi h. Lluja  
**26** Ndikimi i Islamit në mjekësinë botërore I  
Dr. Ibrahim B. Sied  
**28** Le të shikojë njeriu, nga se është krijuar  
Blerim Lazimi  
**30** Dora që tund djepin do të rrisë besimtarët e së ardhmes / Marsela Tarelli

## bota shpirtërore


**34** Fetaria formale  
Dr. Muhamed Amare

## hapësirë femënore

**36** Rugë tjetër, ndjekje e vështirë  
Hapësire Femënore


## këndi i poezisë

**38** Shpirti i dëshmorit  
Hafiz Ali Korça





# 35 VJET LIRI BESIMI



Këtë nëntor të vitit 2025 bëhen plot 35 vjet që jetojmë lirinë e besimit. Pas luftës së dytë botërore, vuajtjet u bënë pjesë e jetës së besimtarëve për gjysmë shekulli, sepse më shumë se çdokush tjetër dhe mbi çdo torturë fizike, besimtarëve iu mohua përkujtimi i Zotit, iu ndrydh ndërgjegjja, iu ndalua besimi dhe komunikimi që ata kishin me Krijuesin e tyre. Politika komuniste bëri një propagandë të ashpër përbuzjen e fesë, nëpërmjet shtypit, radios, formave të edukimit, kinemasë, pjesëve të leximeve shkollore dhe edukimit.

Duke i ndarë në periudha, mund të themi se deri më 1967 u bë likuidimi fizik dhe organizativ i klerit, ndërsa pas kësaj periudhe u vazhdua programi me likuidimin total të objekteve të kultit, duke mos kursyer as ato që konsideroheshin monumente të kulturës, dhe kjo si rrjedhojë e të ashtuquajturit revolucion kulturor. Predikues të të gjitha besimeve fetare vuajtën fate të përbashkëta, u ndaluan të predikonin, u internuan ose u burgosën për veprimtari kundër regjimit komunist. Dhjetëra prijës fetarë u ekzekutuan, u vranë apo vdiqën nëpër burgje. Pasuritë e të gjitha bashkësive fetare u konfiskuan dhe një pjesë u shkatërruan.

Ndalimi i fesë u ligjësuara edhe me Kushtetutën e re të miratuar më 28 dhjetor 1976 nga Kuvendi Popullor, ku te kreu I, neni 37, pika 6 përcaktohet prerazi: "Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah e zhvillon propagandën ateiste për të rrënjësuar te njerëzit botëkuptimin materialist shkencor." Ndërsa te kreu II, neni 55 theksohet: "Ndalohej krijimi i çdo organizate me karakter... fetar... ndalohej veprimtaria dhe propaganda fetare..."

Diktatura komuniste, me tërë egërsinë e vet, hoqi mësimin e besimit nga shkolla, mbylli të gjitha shkollat për përgatitjen e kuadrit fetar, pezulloi shtypin fetar dhe

botimet, sekuestroi të gjitha bibliotekat personale me literaturë fetare, ndaloi funksionimin e objekteve fetare, pengoi zhvillimin e riteve fetare, xhamitë i shndërroi në magazina e stalla dhe, sigurisht, shumicën e tyre i shkatërroi dhe i rrafshoi. Hoxhallarët më të shquar i burgosi dhe i pushkatoi, kurse disa prej tyre i internoi, i la pa punë, u bëri presione që të hiqnin petkun fetar e të mohonin pikëpamjet e tyre, shkurt, u përpoq me çdo mjet që të mos linte asgjë nga feja dhe ndjenjat e popullit për të.

Kur erërat e ndryshimeve frynë në Shqipëri, në fillim të viteve '90-të, pati kërkesa për rikthimin e lirisë fetare. Në përgjigje të këtyre kërkesave, qeveria shqiptare, në vitin 1990, pranoi të lejonte praktikimin publik të fesë, të hiqte ndalimin dhe ndëshkimin për botimin e literaturës fetare dhe të lejonte organizatat dhe institucionet fetare të funksiononin lirisht. Këto nisma nga ana e qeverisë shqiptare shënuan fundin e luftës institucionale kundër fesë dhe fillimin e një epoke të re në këtë drejtim.

Me rënien e regjimit komunist, besimet fetare filluan të riorganizohen mbi bazat tradicionale, duke pasur si bërthamë ato pak objekte kulturi, që ishin shpallur "Monumente Kulture" dhe ato të cilave u ishte ndërruar destinacioni, si dhe ata pak hoxhallarë, që i kishin rezistuar terrorit komunist. Pas 23 viteve të ndalimit të fesë me ligj, Zoti bëri të mundur që me datë 16 nëntor 1990, të rihapet xhamia e parë në Shqipëri, ajo e Plumbit në Shkodër. Rihapja e xhamisë së Plumbit ishte shkëndija e parë, që dha sinjalin fatlum se Islami jo vetëm që nuk ish harruar, por vazhdonte të ishte i gjallë e i freskët në zemrat e shqiptarëve. Ky veprim historik për Shqipërinë, vërtetoi edhe një herë ajetin e Kur'anit Famëlartë: "Thuaj: E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht, e pavërteta është e paracaktuar të zhduket!"<sup>1</sup>

1. Isra'ë, 17:81

Atë ditë, bijë e bija shqiptare morën iniciativën e guximshme për të hapur xhaminë dhe për të rifituar të drejtën e ushtrimit të lirë të besimit fetar. Rreziku ishte shumë i madh, por zemrat e besimtarëve nuk mund të rezistonin më ndalimin e praktikimit të fesë. Pjesëmarrësit në këtë ngjarje tregojnë se ajo ka qenë një ditë sa e gëzueshme e mallëngjyese, po aq e guximshme dhe e rrezikshme për të ardhmen e besimtarëve. Një ftesë me foton e Xhamisë së Plumbit qarkullonte në njerëz me këtë tekst: "Me dt. 16.11.1990 ora 12.00 te Xhamia e Plumbit falet dita e xhumasë. Keni nderin të faleni brenda xhamisë." Komisioni

Lidhur me këtë ditë të shënuar, ish myftiu i Shkodrës, H. Faik Hoxha, mes të tjerash shkruan: "Pesë vjet më parë, një grup qytetarësh, shumica të rinj si..., morën iniciativën e guximshme për të hapur xhaminë, për të falur xhumanë, për të ripërtërirë fenë, për të rifituar të drejtën e ushtrimit të lirë të besimit fetar... Duke përkujtuar këtë ngjarje të shënuar historike, na del përpara ai miting i madh popullor me mijëra pjesëmarrës nga qyteti e fshati, nga të gjitha moshat, të mbledhur me dëshirën dhe vullnetin e tyre të lirë, të cilët shprehën urrejtjen për diktaturën dhe ndjenjat e tyre për fenë. Kjo ngjarje e paharruar jehoi në çdo familje, ajo u bë nxitje për të ndërmarrë vepra të tjera në dobi të gjallërimit të fesë, për të kapërcyer atë periudhë terri ateist 50-vjeçar."<sup>2</sup>

Në këtë ditë të shënuar, ne kujtojmë me respekt 69-vjeçarin Haxhi Hafiz Sabri Koçi, pishtarin e ringjalljes së Islamit në Shqipëri, i cili do të shprehej: "Gëzimi më i madh imi ka qenë më 16 nëntor... sikur linda përsëri. Kur shkova te xhamia, ç'të shihja?! Ishte mbushur zi me njerëz. Vargu i tyre zgjatej deri në kala. Altoparlantët rreth e përreth. S'mund të bëja asnjë hap. Të gjithë filluan të bien në tekbi. Brohoritnin. Masa gjithnjë e më tepër merrte flakë... Kam hipur në një tribunë të ngritur për atë qëllim... Mezi e përmbaja veten dhe s'mundja t'u besoja syve të mi. Thashë: A jam në mend apo s'jam? S'kisha parë në jetën time aq të tubuar... E pashë veten aq të lumtur, sa që nuk kisha gjale edhe sikur të bija kurban. Nuk kishte gëzim më të madh për jetën."<sup>3</sup> Gjatë një interviste e pyetën Hafiz Sabriun: "A menduat për pasojat që mund të kishit në drejtimin e kësaj ceremonie?" Ai u përgjigj: "Duke kujtuar të gjitha vuajtjet e mundimet, nuk kisha se çfarë të humbisja. Përkrahur nga djemtë dhe i ftuar nga rinia e mrekullueshme shkodrane, unë e ndjeja veten superior ndaj atyre që duhej të kisha frikë."<sup>4</sup>

2. Faik Hoxha, Duke kujtuar një përvjetor, gazeta "Drita Islame", nr. 21 (82), viti IV i botimit, dhjetor 1995.

3. Pjesë nga intervista e H. Sabri Koçit, Shqipëria i kthehet fesë, revista "El-Hilal", botim special, qershor 1991, f. 13-14; 16 nëntor 1990, gazeta "Drita Islame", nr. 11 (334), viti i XIX i botimit, nëntor 2010.

4. Faik Luli – Islam Dizdari, Një jetë në shërbim të fesë, Tiranë 1996, f. 56.

Do të ishin Hafiz Qazim Rakipi që këndoi versetet Kuranore, si dhe hoxha i nderuar Imam Vehbi Dani që këndoi ezanin, pas 23 vitesh heshtje. I burgosur për 22 vjet nga regjimi komunist, Haxhi Hafiz Sabri Koçi vuri në dukje në fjalën e hapjes, nevojën e ushtrimit të fesë nga çdo njeri dhe në çdo kohë. Ai pasi falënderoi Zotin për mirësitë e Tij të panumërta, në fjalinë e parë gjatë ligjëratës para xhamisë, i hipur në një tribunë të improvizuar tha: "Të dashur vllazën myslimanë, katolikë e ortodoksë, e mbi të gjitha vllazën shqiptarë", pastaj vlerësoi lart mundin dhe përpjekjet e të gjithë atyre që ndihmuan në rikthimin e xhamisë në gjendjen e saj funksionale. Nga xhamia e Plumbit u dëgjuan pas shumë vitesh ajetet e Kur'anit dhe Hadithet e Muhamedit (a.s.), të cilat me besnikërinë më të madhe i kishte ruajtur në kujtesën e tij Hafiz Sabriu.

Duke përkujtuar këtë ngjarje, këtë ndodhi të madhe, Ismail Muçej, ish kryeredaktor i gazetës "Drita Islame", shprehet: "Deshi s'deshi qeveria e asaj kohe, feja u legalizua praktikisht, duke dhënë shkëndijën e parë për qytetet dhe fshatrat e tjera të Shqipërisë, të cilat filluan të hapin njëra pas tjetrës faltoret."<sup>5</sup>

Rihapjet e xhamive anembanë vendit pasuan me hapa të shpejta. Mund të përmendim xhaminë Mbret në Berat, e cila u rihap më 14.12.1990, xhaminë e Plumbit në Vlorë, e cila u rihap më 11.01.1991, xhaminë e Kokonozit (pazari i ri) në Tiranë, e cila u rihap më 18.02.1991, xhaminë Fatih në Durrës, e cila u rihap më 07.03.1991, xhaminë e madhe në Durrës, e cila u rihap më 24.03.1991, xhaminë në qytetin e Fierit, e cila u hap më 12.04.1991, xhaminë në Koplik, e cila u hap më 21.04.1991, xhaminë në Patos, e cila u hap më 07.12.1991, etj.

Kështu, dalëngadalë, me një punë të kujdesshme e plot sakrificë, filluan të hapen xhamitë e para, të meremetohen ato që kishin mbetur kur dorëzoheshin nga organet e pushtetit, u hapën salla për të kryer faljet e predikimet e rastit në ato vende ku nuk kishte xhami, si dhe u ndërtuan xhami të reja.

Ngjarja e 16 nëntorit nuk ishte thjesht një ceremoni fetare. Ajo krahas vlerës së vet të ringjalljes së fesë, ishte një dritë shprese për të ardhmen e Islamit në Shqipëri. Po atë ditë u vendos rithemelimi i institucionit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, i cili, me ndihmën e Zotit, me shumë mund dhe sakrificë, arriti të ngrihet së bashku me myftinitë dhe medresetë, një institucion që i shërben mbarë popullit shqiptar në të gjitha drejtimet.

5. Ismail H. Muçej, Tri vjet pas rihapjes së institucioneve fetare në Shqipëri, gazeta "Drita Islame", nr. 18 (43), viti II i botimit, dhjetor 1993.



# *Roli i prijësve myslimanë në formimin e shtetit të parë shqiptar*



Shekulli XIX shënoi një epokë të re për popullin shqiptar, atë të Rilindjes. Ai hyri në historinë moderne të vendeve të Ballkanit si shekulli i lëvizjeve dhe revolucioneve kombëtare, që çuan në çlirimin dhe formimin e shteteve të pavarura. Për një varg rrethanash të brendshme e të jashtme, Shqipëria ishte vendi i fundit në Ballkan që u shkëput nga Perandoria Osmane dhe që shpalli pavarësinë kombëtare. Gjatë Rilindjes Kombëtare lindi dhe u zhvillua ideologjia e re kombëtare, e cila, duke u ngritur mbi ndarjet krahinore e fetare, shprehte aspiratat jo më të krahinave të veçanta, por të gjithë Shqipërisë dhe shqiptarëve si komb.<sup>1</sup>

Lëvizja Kombëtare Shqiptare për pavarësi dhe krijimi i shtetit shqiptar të pavarur, përbën një shembull mjaft domethënës të bashkëpunimit të sinqertë dhe pa asnjë paragjykim të intelektualëve dhe aktivistëve patriotë, të cilët, pavarësisht nga përkatësia e ndryshme fetare, dhanë një kontribut vendimtar për afirmimin politik e kulturor të kombit shqiptar. Të dhënat e përfutuara nga burime

të ndryshme historike vërtetojnë qartësisht ekzistencën e tolerancës dhe të bashkëjetesës paqësore midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme.

Periodha e Rilindjes Kombëtare, ajo e pavarësisë dhe e luftërave të ndryshme në mbrojtje të trojeve shqiptare, dëshmuar se ekzistenca e besimit fetar, jo vetëm që nuk u bë pengesë për përballimin e situatave të vështira të atyre kohëve, por shërbeu si faktor i domosdoshëm për ruajtjen e pavarësisë dhe forcimin e shtetit, duke u vlerësuar se diversiteti fetar ka qenë dhe është një pasuri kombëtare, kjo falë prijësve të shquar fetarë. Shumë kuvende e kryengritje lokale, krahinore, ndërkrahinore dhe mbarëkombëtare u udhëhoqën dhe u drejtuan nga klerikë të shquar shqiptarë. Një realitet ky i cili herë pas here vlerësohet edhe nga opinioni ndërkombëtar.

Kur udhëton nëpër analet e historisë shqiptare dhe flet për lëvizjet dhe përpjekjet mbarëkombëtare, kupton se një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe rilindësit e mëdhenj shqiptarë, të cilët në shumë raste ishin drejtues fetarë, që nga imamë

1. ASHSH, "Histori e Popullit Shqiptar, Vëll. II, Toena, Tiranë 2002, f. 27.



e myderrizë, myfti, kryemyfti, kadi dhe kryetar komuniteti e deri në klerikë katolikë e ortodoksë, ku në kushte dhe rrethana të ndryshme dhe shpeshherë mjaft të vështira, punuan për krijimin dhe ngritjen e shtetit shqiptar, si dhe kontribuan për forcimin dhe konsolidimin e tij.

Është e qartë që kleri mysliman ka dhënë një kontribut të veçantë për ekzistencën e popullit dhe të kombit shqiptar. Në përpjekjet dhe në luftën e gjatë për ruajtjen e identitetit kombëtar, ai ka marrë pjesë në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme. Mjafton të hedhim një sy me kujdes në të gjitha ngjarjet me karakter historik dhe politik dhe do vëmë re se prania e prijësve myslimanë është kudo e pashmangshme. Që nga kryengritjet kundër Tanzimatit me sheh Mustafën e sheh Fezën e deri te përfaqësimi në organizma si Komiteti i Stambollit, me Hoxha Hasan Tahsinin e madh, duke vazhduar me Daut Efendi Boriçin, në Lidhjen e Prizrenit, me Hafiz Ibrahim Shkupin, në Kongresin e Manastirit, me Myfti Vehbi Dibrën, Hafiz Ali Korçën dhe Ismail Efendi Ndroqin në Kongresin e Dibrës, me Myfti Vehbi Dibrën e Sheh

Ahmet Pazarin në shpalljen e Pavarësisë më 1912 dhe ngritjen e flamurit, etj.

Pra, në gjithë rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve, pa dyshim, gjen edhe ata, krerët e besimit mysliman, krah për krah, dorë për dorë e gojë për gojë me të gjithë klerikët e besimeve të tjera në Shqipëri.

Ngjarje të rëndësishme mbarëkombëtare janë të lidhura me zhvillimin e tyre pranë institucioneve fetare gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare si p.sh., Lidhja Shqiptare e Prizrenit u ndez në Medresenë e Xhamisë Bajrakli. Kryetari i saj pas Iljaz pashë Dibrës, u zgjodh kleriku Haxhi Ymer Prizreni, që ishte dhe kryeministri i parë shqiptar në Qeverinë e përkohshme të Lidhjes. Ishin klerikët ata që kontribuan së bashku me personalitete të shquara të vendit, për hapjen e mësonjëtorëve të para në gjuhën shqipe dhe për t'u mësuar fëmijëve shkrimin e këndimin e shqipes, si Hoxha Tahsini, Said Najdeni, Vehbi Dibra (Agolli), Hafiz Ali Korça etj.

Gjatë viteve 1900-1912, ata i gjejmë të pranishëm në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të jetës politike, social-arsimore të vendit tonë, në kuvende

dhe kongrese mbarëkombëtare si: Kuvendi i Pejës, i drejtuar nga kleriku Haxhi Zeka, kongreset arsimore të Manastirit e Ebasanit, në Kongresin e Dibrës të 23 korrikut 1909, të drejtuar nga Vehbi Dibra, në kuvendin e madh të Vlorës etj. Me mendimin dhe qëndrimin e mbajtur, klerikët shqiptarë luajtën rol të rëndësishëm në orientimin kombëtar të tërë jetës së vendit tonë. Në gjirin e kësaj lëvizje të gjerë politike, arsimore dhe ushtarake, ata bashkëvepruan dhe me figura të rëndësishme të lëvizjes sonë kombëtare Ismail Qemalin, Isa Boletinin, Hasan Prishtinën, Luigj Gurakuqin etj.

Në kuvendin e Pejës dhe të Dibrës të vitit 1899, Haxhi Zeka, Selim Rusi, Vehbi Dibra, Myfti Saliu, Myderiz Ismaili, Myderiz Abdullahu etj., luajtën një rol të rëndësishëm, duke dhënë një shembull se si duhej të zgjidhej çështja kombëtare. Klerikët jo vetëm ishin përfaqësues të krahinave të ndryshme shqiptare në këto kuvende, por dhe figura me shumë reputacion në delegatët e tjerë pjesëmarrës të këtij kuvendi. Fjala e tyre zinte vend sa herë që shprehej.

Përhapja e shkollave dhe e mësimin të gjuhës shqipe, si dhe zhvillimi i kulturës kombëtare, shtruan nevojën e caktimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Për këtë u organizua Kongresi i Manastirit më 14 nëntor 1908. Delegatët e kongresit ishin shkrimtarët dhe publicistët më të njohur, lëvruet të gjuhës shqipe, laik e klerikë si: Vehbi Dibra, Haziz Ibrahim efendiu etj., shtruan domosdoshmërinë e caktimit të një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe.<sup>2</sup> Në këtë kongres klerikët mbështetën idenë për përdorimin e një alfabeti të ri të gjuhës shqipe me germa latine dhe për mësimin e shqipes në shkollat e Shqipërisë.<sup>3</sup>

Në Kongresin e Dibrës të mbajtur më 23 korrik 1909, Vehbi efendi Dibra, Hafiz Ali Korça, Haxhi Hafiz Ibrahim efendiu, Hafiz Sherif Lëngu, etj., do të krijonin klube shqiptare e do të viheshin në krye të luftës kundër xhonturqve që përpiqeshin të pengonin zhvillimin e kombit shqiptar, bashkimin e tij. Në Kongresin e Dibrës, Vehbi Dibra për aktivitetin e tij fetar dhe politik do të zgjidhet kryetar i Kongresit. Ky kongres i kalonte caqet kombëtare, gjë që tregohet nga pjesëmarrja e delegatëve laikë e klerikë jo vetëm nga vilajetet e Selanikut, Manastirit, Janinës, Kosovës dhe Shkodrës, por dhe e përfaqësuesve serbë, grekë, bullgarë e vllah. Ky ishte i pari kongres ku më tepër se 300 delegatë toskë, gegë, myslimanë, ortodoksë, katolikë, priftërinj, hoxhallarë e shehelerë u konvertuan në një pikë, shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia dhe arritjen e pavarësisë kombëtare.

Atdhetarët Hafiz Ali Korça, Abdyl Ypi, Kenan Manastirli, Vehbi Agolli, Haxhi Ali Elbasani, etj., e bënë Kongresin e Dibrës arenë të luftës dhe shpalosjes së mendimit e

2. ASHSH, "Histori e Popullit Shqiptar, Vëll. II, Toena, Tiranë 2002, f. 392.

3. Prof. dr. Qazim Xhelili, Monografi, "Vehbi Dibra", Tiranë: Albin 1998, f. 27.

kërkesave të mirëfillta të shqiptarëve, kërkesa që ishin nga më të avancuarat të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si rezultat i kësaj lufte kongresi punimet e tij i nisi dhe i përfundoi si një kongres shqiptar, si një kongres që trajtoi dhe shumë probleme të rëndësishme kombëtare që dilnin dhe jashtë kopetencave të rendit të ditës. Në të u ngritën probleme me kërkesa të mirëfillta shqiptare ku u shfaqën hapur:

- kërkesat me karakter të theksuar politik kombëtar, që çonin drejt realizimit të autonomisë së Shqipërisë,
- kërkesat për hapjen e shkollave shqipe të mbrojtura nga shteti,
- futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore,
- çështjen e alfabetit etj.<sup>4</sup>

Punimet e Kongresit, lufta e ashpër politike që u zhvillua aty, provuan plotësisht se kërkesat e delegatëve patriotë ishin një përpjekje e hapur për realizimin e autonomisë së Shqipërisë. Kërkesa të tilla si ajo që nëpunësit e administratës vendase të dinin gjuhën dhe zakonet e vendit, futja e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore, hapja e shkollave në gjuhën shqipe, kryerja e shërbimit ushtarak në vend, përdorimi dy gjuhësh në dokumentat përfundimtare të tij, janë arritjet më të mëdha të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, suksese që nuk ishin arritur në kongreset e tjera kombëtare.<sup>5</sup>

Në Kongresin e Elbasanit të 2 shtatorit 1909, prijësit myslimanë Hafiz Ibrahim Dalliu, Josi Haxhi Mima, Emin Haxhi Ademi dhe Hoxhë Muglica, bënë gjithçka për të hapur Normalen e Elbasanit, përkrah Luigj Gurakuqit, Hamdi Ohrit, Dervish bej Biçakut, Mit'hat Frashërit dhe të tjerëve.

Elita fetare e vendit ka meritat më të para nga të gjitha elitat e tjera. Në rast se vështrojmë kombet dhe historitë e tjera do të gjeni kombe të cilat kanë tradita mijërvjeçare shkrimi, alfabetesh, bibliotekash librash dhe qytetërimi. Por, kombi ynë ka një specifikë që nuk e ka asnjë komb tjetër, që është diamant i qytetërimit të kombeve, kjo është toleranca fetare. S'ka dhe s'mund të ketë asnjë tregues më epror për qytetarinë e një kombi sesa toleranca fetare.

Shqipëria përgjatë historisë së saj ka qenë një shembull se si njerëzit e fesë kanë ditur të zgjidhin saktë marrëdhëniet e besimit me kombin. Një mori dijetarësh shqiptarë të profilit fetar mysliman, katolik apo ortodoks kanë dhënë kontribut të çmuar në të gjitha fazat zhvillimore dhe format organizative të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Prijësit myslimanë, duke ruajtur tolerancën fetare, janë përpjekur në të gjitha mënyrat vetëm për një shoqëri me parime patriotike, për një shoqëri bashkëkohore, për forcimin e ndërgjegjes kombëtare, dashurisë për gjuhën dhe traditat shqiptare, dashurisë për atdheun e dashurisë për njëri-tjetrin. Më në veçanti kjo vepër bën ekzaminimin e përpjekjeve

4. Gazmend Shpuza, "Kongresi kombëtar i Dibrës 1909", Dibër 2005, f. 32.

5. Manastirli Kenan, "Kongresi i Dibrës", Stamboll 1912, f. 7.



madhore të dijetarëve myslimanë që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri në pavarësinë e Shqipërisë, jo vetëm për çlirim kombëtar, jo vetëm për arsimin e shkollat shqipe, por krijimin e shtetit shqiptar. Me firmën jo vetëm të patriotëve shqiptarë, por dhe të klerikëve myslimanë si: Hafiz Ismet Dibra, Vehbi Dibra, Hafiz Sherif Lëngu, etj., Shqipëria të shpallej e pavarur.<sup>6</sup>

Pavarësia e Shqipërisë ishte aspiratë dhe punë atdhetare e një kombi të tërë nga gjiri i të cilit lindën shumë heronj. Midis tyre historiografia jonë duhet të nënvizojë fort emrat klerikëve myslimanë, njerëz me shumë reputacion në mbarë Shqipërinë, të aftë, largpamës, me nuhatje e drejtpeshim politik.<sup>7</sup>

Kulmin e ngritjes së tyre jo vetëm si klerikë, por dhe si luftëtarë të çështjes kombëtare, këta klerikë do ta arrijnë me pjesëmarrjen në Kuvendin e Vlorës dhe zgjedhjen e tyre në organet më të larta të Qeverisë së Përkohshme.

Në situatën e krijuar, kur forcat ballkanike po pushtonin Shqipërinë dhe trevat shqiptare rrezikoheshin nga një copëtim i ri, rrethet atdhetare shqiptare brenda dhe jashtë atdheut arritën në përfundimin se, e vetmja rrugë për shpëtimin e Shqipërisë ishte shpallja e Pavarësisë. Për këtë qëllim do të organizonin një kuvend mbarëkombëtar ku do të mernin pjesë delegatë të zgjedhur nga të gjitha krahinat shqiptare.

Telegrame të shumta të dërguara nga Vlora për Prefekturën e Elbasanit tregonin interesin e veçantë që kishin organizatorët e kuvendit për arritjen në Kuvendin e Madh të përfaqësuesve të klerikëve mysliman si: Vehbi Agolli (Dibra) dhe Hafiz Sherif Lëngu,<sup>8</sup> personalitete me kontribut fetar e politik të gjithanshëm për çështjen kombëtare, mandate që ua ngarkonte mbarë popullsia e Dibrës dhe e krahinave përreth për të dërguar fjalën e tyre në Kuvendin Kombëtar në Vlorë.<sup>9</sup>

Për të plotësuar këtë detyrë të vështirë, mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, më 21 nëntor 1912, Ismail Qemali arriti në Durrës. Plaku Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi e atdhetarë të tjerë të shoqëruar nga Nikoll Kaçorri u nisën për në Vlorë.

Më 21 nëntor 1912, Isa Boletini, Ajdin bej Draga, Mehmet pashë Dërralla dhe delegatët e zgjedhur të Dibrës, Vehbi Agolli dhe Hafiz Sherif Lëngu, u nisën nga Dibra për në Elbasan<sup>10</sup>, ku i prisnin delegatët e kësaj treve për të shkuar së bashku drejt Vlorës.<sup>11</sup>

Ndërsa delegatë nga të gjitha krahinat e tjera shqiptare grupoheshin dhe së bashku niseshin për në Vlorë. Qyteteve shqiptare që rrezikoheshin nga pushtimi i shteteve fqinje iu kërkua që ta ngrinin sa më shpejt flamurin kombëtar, me qëllim që pushtuesi i ri t'i gjente

të pavarura. Midis 37 delegatëve<sup>12</sup> dalloheshin klerikët Vehbi Agolli, Hafiz Sherif Lëngu dhe Dom Nikoll Kaçorri.

Përballë kërcënimit të ri të pushtimit nga ushtritë ballkanike dhe situatës së re të krijuar për trevat shqiptare, Ismail Qemali dhe atdhetarë të tjerë të mbledhur në Vlorë, hapën më 28 nëntor 1912, ora 14.00, punimet e Kuvendit Kombëtar për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, pa pritur ende të gjithë delegatët e krahinave shqiptare për shkak të vështirësive të mëdha që ekzistonin. Mendimi i klerikëve për Pavarësinë e Shqipërisë, u mbështet nga të gjithë delegatët me në krye Ismail Qemalin, të cilët e shpallën Shqipërinë shtet të pavarur: "Shqipëria më sot të bëhet më vehte, e lirë e mosvarme".<sup>13</sup>

Pas shpalljes së pavarësisë, përpara kuvendit kombëtar shtroheshin detyra të reja historike: të ngrihej shteti i pavarur shqiptar me administratën dhe forcat e tij të armatosura, të sigurohej njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe e kufijve politikë shtetërorë që të përfshiheshin të gjitha trojet etnike shqiptare, të shtriheshin pushteti shtetëror në këto troje dhe të organizohej mëkëmbja dhe zhvillimi ekonomik i vendit.

Ismail Qemali i paraqiti Kuvendit dhe ia besoi atij zgjedhjen e anëtarëve të qeverisë. Rrjedhimisht anëtarët e saj duhet të ishin të njohur brenda dhe jashtë vendit. Më 4 dhjetor 1912, u zgjodh Qeveria e Përkohshme<sup>14</sup>. Në përbërjen e këtij kabineti qeveritar spikasnin krahas figurave të tjera atdhetare Myfit bej Libohova, Abdi bej Toptani, Mehmet pashë Deralla, Petro Poga, Luigj Gurakuqi, Mithat Frashëri, Pandeli Cale, Les Nosi dhe figurat e dy klerikëve Dom Nikoll Kaçori dhe Vehbi Agolli.

Me propozim të Ismail Qemalit, në Kuvend u zgjodhën dhe organet më të larta të përfaqësimit të qeverisë shqiptare. Në mbledhjen e dytë, që u hap më 30 nëntor 1912, me propozim të Luigj Gurakuqit, Vehbi Agolli u propozua të zgjidhej kryetari i Pleqësisë shqiptare (senatit). Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi jo vetëm Qeverinë e Përkohshme, por dhe Pleqësinë prej 18 anëtarësh. Kryetar i pleqësisë u zgjodh Vehbi Dibra.<sup>15</sup> Në Kuvendin e Vlorës, Vehbi Agolli bëri dhe betimin e flamurit dhe dha Fet'fanë për shpalljen e pavarësisë. Kjo që zgjedhja e dytë e një atdhetari klerikal në postet më të larta të qeverisjes pas zgjedhjes së Dom Nikoll Kaçorrit si nënkryetar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ndërkohë që Ismail Qemali merrej me zgjidhjet diplomatike të shtetit shqiptar jashtë atdheut, aktivitetin brenda tij e ushtronte Vehbi Dibra, mjaft i sukseshëm në shtrirjen e autoritetit të shtetit të parë shqiptar në të gjitha trevat shqiptare.

6. Kamberi Moisi, "Dibra në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare", Maluka, Tiranë 2012, f. 176.

7. M. H. D. Fondi Dosje Patriotësh, Vehbi Dibra, dosja, nr. 598.

8. A.Q.SH. - Fondi 71, D 1, Përkthim nga turqishtja.

9. Zani i Naltë, viti 1937.

10. A.Q.SH.- Fondi - 245, D. 2, f. 6, viti 1912.

11. A.Q.SH. - Fondi 32, D. 26, f. 133.

12. Valentina Duka - "Histori e Shqipërisë 1912-2000", Tiranë: Shblu, 2007, f. 19.

13. Histori e Popullit Shqiptar, Vëll. II, Tiranë: Toena 2002, f. 511.

14. Xhafa Bajram, "Historia e Shqipërisë, periudha e pavarësisë", Shkodër 2006, f. 16.

15. Valentina Duka, "Histori e Shqipërisë 1912-2000", Tiranë: Shblu, 2007, f. 24.

## 01 XHAMIA "BALLIE" NË ELBASAN MIRËPRET "FRYTET E BESIMIT"



Në një atmosferë të ngrohtë besimi dhe vëllazërie, Xhamia Ballie në Elbasan mirëpriti mbrëmjen e djeshme ciklin e ligjëratave fetare "Frytet e Besimit".

Kjo mbrëmje u çel me fjalën përshëndetëse të Myftiut të Elbasanit, z. Agim Duka, i cili vuri theksin në vlerën e duase si lidhja më e sinqertë mes njeriut dhe Krijuesit, burim paqeje dhe forcë e brendshme e çdo besimtar.

Më pas, Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, foli mbi rëndësinë e besimit si shtyllë themelore e qëndrueshmërisë shpirtërore dhe morale të njeriut, duke theksuar se ai është udhërrëfyesi që i jep kuptim jetës dhe vlerë çdo veprimi.

Në vijim, z. Erjol Haxhiu, Drejtor i Thirrjes dhe Mesazhit Islam në KMSH, ndau mesazhe të vyera mbi mënyrat e forcimit të besimit dhe pasqyrimin e virtyteve të tij në përditshmëri, si mirësia, durimi dhe ndershmëria.

Në përmbyllje, z. Shpëtim Seranaj, Drejtor i Marrëdhënieve me Besimtarët në KMSH, trajtoi rolin e besimit në ruajtjen dhe forcimin e familjes, duke theksuar se besimi i përbashkët është nyja që bashkon zemrat, ushqen dashurinë dhe mban gjallë mirëkuptimin mes anëtarëve të saj.

Aktiviteti mbledhi besimtarë të shumtë që dëgjuan me vëmendje referimet e ligjëruessve të lartpërmendur.





## 02 KRYETARI I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË VIZITON PANAIRIN KOMBËTAR TË LIBRIT 2025



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, vizitoi sot Panairin Kombëtar të Librit Tirana 2025, i cili po zhvillohet në Pallatin e Kongreseve në Tiranë nga 12 deri më 16 nëntor.

Gjatë vizitës së tij, kryetari Spahiu ndaloi në disa stenda të shtëpive botuese nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, ku u njoh me botime të reja me vlera kulturore, shkencore dhe fetare.

Një ndalesë ai e bëri edhe në stendën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, ku janë ekspozuar rreth 40 tituj librash në fusha të ndryshme si tefsiri, fikh, historia islame, çështjet sociale e shkencore, si dhe botime nga dijetarët shqiptarë.

Kryetari Spahiu vlerësoi Panairin e Librit si një ngjarje të rëndësishme kulturore e shpirtërore, që nxit dashurinë për librin dhe dijen, duke theksuar se libri mbetet ura më e fortë mes brezave dhe dritë për mendjen e shpirtin e njeriut.

Ju ftojmë të vizitoni stendën e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe të përfitonit nga kjo mundësi për të zbuluar libra me vlera shpirtërore, kulturore e shoqërore.





### 03 KOMUNITETIT MYSLIMAN I SHQIPËRISË NË NDIHMË TË FËMIJËVE TALASEMIKË



Komuniteti Mysliman i Shqipërisë vijon fushatën e dhurimit të gjakut në mbështetje të fëmijëve talasemikë, një nismë që ka marrë përmasa kombëtare falë bashkëpunimit të ngushtë me Kryqin e Kuq Shqiptar.

Që prej nisjes së fushatës së këtij viti, dhjetëra xhami në kryeqytet dhe në qytete të tjera të vendit janë bërë pika ku besimtarët dhe qytetarët kanë dhuruar gjak në mbështetje të kësaj kauze kaq fisnike.

Falë këtij mobilizimi, deri më tani janë mbledhur rreth 500 njësi gjaku, një kontribut i çmuar për fëmijët që vuajnë nga talasemia – sëmundje që, fatkeqësisht, prek një numër të lartë fëmijësh në vendin tonë.

Fushata nuk është mbyllur. Ajo vazhdon, sepse nevojat janë shumë më të mëdha se sa dhurimet që realizohen çdo ditë.

Allahu (xh.sh.) i shpërbleftë të gjithë myftinjtë, imamët dhe kuadrot e tërë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për kontributin në organizim dhe të gjithë ata që kanë dhuruar dhe ata që do të dhurojnë në vijim!



## 04 VIZITË PUNE NË MYFTININË E LUSHNJES



Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me anëtarë të kryesisë, zhvilloi një vizitë pune në Myftininë e Lushnjes, ku u prit nga Myftiu Gramos Blliku, administratori dhe imamët e zonës.

Kjo vizitë, pjesë e turit të takimeve në myftinitë e vendit, u fokusua në vlerësimin e ecurisë së punës dhe zbatimit të objektivave të planit strategjik 2024–2029.

Në hapje të takimit, Myftiu Blliku u shprehu mirëseardhjen e tij të pranishmëve dhe nënvizoi angazhimin e stafit në punët dhe përgjegjësitë e përditshme.

Ndërsa, Kryetari Spahiu përgëzoi Myftiun dhe imamët për punën e tyre të deritanishme, duke vlerësuar angazhimin në aspektin fetar dhe atë social.

Fjalë të rastit mbajtën gjithashtu Nënkryetari i Institucionit, z. Taulant Bica, Kancelari dhe anëtarët e tjerë të kryesisë të pranishëm në takim, të cilët u ndalën në çështje të ndryshme të aktualitetit dhe përgjegjësiave përkatëse.

Takimi u zhvillua më tej në formën e një diskutimi të hapur mbi tematika të ndryshme.





## 05 MEDRESEJA E TIRANËS ZHVILLON PROGRAM FESTIV ME RASTIN E 28-29 NËNTORIT



Në kuadër të festave të nëntorit, Medreseja e Tiranës zhvilloi një program artistik të pasur me poezi, interpretime të ndryshme teatrale dhe folklorike kushtuar vlerave dhe domethënies së këtyre dy datave historike të kombit tonë.

Aktiviteti mbledhi në një atmosferë festive prindër, mësues dhe një numër të madh nxënësish, të cilët u bënë pjesë e një shfaqjeje plot ngjyra dhe emocione.

Të pranishëm në këtë organizim ishin edhe Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Lauren Luli, Drejtori i Shkollës, z. Ardit Dragoti, si dhe Drejtori i Kulturës në KMSH, z. Dorian Demetja.

Në fjalën e tij përshëndetëse, drejtori i shkollës theksoi rëndësinë e organizimit të aktiviteteve të tilla, të cilat synojnë zhvillimin artistik e kulturor të nxënësve, duke nënvizuar se këto programe shërbejnë gjithashtu për të përcjellë me dinjitet vlerat tona kombëtare tek brezat e rinj.

Ndërsa Nënkrjetari Luli, pasi përgëzoi organizatorët, solli në vëmendje sakrificën e të gjithë atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit, duke theksuar se kujtimi dhe nderimi i tyre mbetet detyrë morale e të gjithëve ne.

Aktiviteti vijoi më tej me interpretimet e nxënësve, të cilët sollën në skenë pjesë të ndryshme teatrale, poezi dhe fragmente që pasqyruan me krenari historinë tonë kombëtare.





## 06 KMSHZ ZHVILLON SIMPOZIUMIN SHKENCOR NDËRKOMBËTAR



Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ) zhvilloi ditën e djeshme një simpozium shkencor ndërkombëtar, me temë: “Xhamitë shqiptare në mërgatë në shërbim të kombit, fesë dhe integritit”.

Ky organizim mbledhi së bashku drejtues komunitetesh fetare nga vende të ndryshme të rajonit dhe Evropës, imamë, studiues, pedagogë, dhe aktivistë.


I pranishëm në këtë simpozium ishte edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i shoqëruar nga Nënkrjetari i institucionit, z. Lauren Luli.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Kryetari Spahiu vlerësoi kontributin e komunitetit shqiptar në mërgatë dhe theksoi përgjegjësinë për të ruajtur unitetin, bashkëpunimin dhe vlerat fetare e kombëtare.

Në referimet e tyre, pjesëmarrësit theksuan se xhamitë shqiptare në diasporë nuk janë vetëm vende adhurimi, por institucione të gjalla që ruajnë gjuhën, kulturën dhe identitetin tonë të përbashkët. Në këtë kuadër u prezantuan kumtesa me vlera studimore, të cilat trajtuan rolin historik e bashkëkohor të xhamive shqiptare në Evropë, përgjegjësitë e imamëve në edukimin e brezave, funksionin e xhamisë si hapësirë dialogu e solidariteti, sfidat e organizimit komunitar në mërgatë dhe domosdoshmërinë e një identiteti të shëndoshë fetar e kombëtar.



# Islami dhe Shkenca Moderne



Qytetërimi Islam duke patur parasysh kushtet e mesjetës, faktohet edhe nga shumë studjues modern që ka pasur traditë të shkëlqyer shkencore. Kështu që, pavarësisht mendimeve negative të hedhura herë pas here gjoja për mosprodhimin e një tradite "shkencore", apo moskontribumin në historinë shkencore njerëzore, nuk janë probleme që burojnë nga brenda. Nga ana tjetër, një fakt i rëndësishëm dhe që e bën këtë akumulim të kuptueshëm është përkthimi i trashëgimisë shkencore të prodhuar nga myslimanët e mesjetës në gjuhët Latine dhe Hebraike. Më pas, duke i përcjellë në Perëndim do të luante një rol shumë të rëndësishëm në lindjen e një botkuptimi të ri në shkencë dhe arsim. Përzgjedhja në kohët moderne nga shkencëtarët perëndimorë si metoda të fizikës matematikën dhe jo logjikën e Aristotelit, megjithëse e redukton fushën e ekzistencës fizike në

numra si dhe rrezikun metafizik që përmban, tani bën të mundur të dalin në pah horizonte të reja të konceptit teorik-shkencor të bazuar në vërtetime dhe eksperimente si dhe lindjen e një botëkuptimi të ri shkencor. Nevojat e tranzicioneve të ndryshme sociale, politike dhe kulturore, çoi në kërkimin e zgjidhjeve të reja në këtë kohë të imponuara nga nevojat, shpikjet e njëpasnjëshme mekanike, revolucionin shkencor të Njutonit e ndoqi revolucionin industrial, shkenca moderne u bë metoda themelore që mundeson industrinë dhe teknologjinë perëndimore.

Ndërkohë që në Perëndim ndodhnin zhvillimet e lartpërmendura, në botën Islame, qëndrimi indiferent ndaj këtyre zhvillimeve deri në kohën kur filluan të mendonin për shkakun e disfatës ushtarake përballë luftëtarëve të qytetërimit të ri, çoi në krijimin e një distance midis



qytetërimeve të Perëndimit dhe Islamit e shkaktuar nga zhvillimi me ritme të shpejta të shkencës dhe teknologjisë. Fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX shënoi distancimin e dijetarëve dhe mendimtarëve myslimanë ndaj Perëndimit. Distanca tragjike e cila gjunjëzoi Islamit përballë Perëndimit dhe së fundi, lindja e dyshimeve në vlerat fetare ku bazohej qytetërimi tradicional Islam tek të rinjtë të cilët kishin kontakte me kulturën Perëndimore, lindi nevojën e rishikimit të lidhjeve ndërmjet Islamit dhe shkencës. Konferenca me temë "Islami dhe shkenca" e mbajtur në Universitetin e Sarbonës nga Ernest Renan ku trillonte mendimin se sistemi i vlerave të Islamit përbënte pengesë për zhvillimin e shkencës, shkaktoi reaksion për shkrimin e shumë veprave përgjigjeje nga shkrimtarët myslimanë me në krye Xhemaleddin Efganin dhe Namik Qemalin si dhe diskutimeve moderne Islame.

Teza se Islami përbën pengesë për zhvillimin e shkencës ka zënë një vend të rëndësishëm. Këtë e ndoqi teza se të vërtetat e Islamit nuk bien ndesh me të dhënat e shkencës moderne dhe më pas u forcua luhata e komentimit të Kur'anit të bazuar në të dhënat e shkencës moderne. Kjo përqasje në të kaluarën e afërt i takon punimeve të famshmit Maurice Bucaille, i cili mendohet që në botën Islame sikur përhapte një levizje "bucaille"izmi. Në gjysmën e dytë të shekullit të njëzet nuk ishte vetëm "bucaille"izmi i vlefshëm, por mendimtarë si Sejjid Husejin Nasr, Nakib el-Attasi, Ismail Raxhi el-Faruki mbrojtën mendimin se shkenca perëndimore nuk është e pavarur nga sistemi i vlerave, teza moderne Islame e formuar, se nga Perëndimi të marrim shkencën dhe të lëmë moralin është e pamjaftueshme dhe që shkenca e zhvilluar në Perëndim me formën moderne duhet islamizuar. Nasri dhe Attasi të mbështetur në traditën Islame mistike-agnostike (tasavvufi-irfanî) kritikuan botën e mendimit modern dhe pozitivizmin ku pëfundimisht mbështetet shkenca moderne. Sipas tyre është e pamundur të shpëtohet nga rreziku që i drejtohet njeriut dhe natyrës nga mbetjet teknologjike të shkencës Perëndimore pa u mundësuar kontakti i saj i ri me mësimet e shenjta dhe universale të metafizikës, shkurtimisht me traditën hyjnore. Ndërsa Faruki, duke qenë më kritik ndaj Sufizmit, njohu si çështje themelore për një arsim Islam, islamizimin e dijes, të kaluarë në disa faza rehabilitimi dhe këtë program e rrethoi në fushën e shkencave sociale. Termat që dolën nga këto diskutime si shkenca Islame (Islamic Science), islamizimi i dijes (Islamisation of Knowledge) tërhoqën vëmendjen dhe hapën debate. Disa mendimtarë dhe nga profesioni shkenctarë mbrojtën mendimin se dija është e pavarur nga vlera, disa të tjerë duke u referuar në qytetërimin Islam, përvojën historike dhe për arsye të çështjes metodologjike e panë të arsyeshëm termin shkenca Islame. Ndërsa për projektin e islamizimit të dijes të hedhur nga Faruki, u shprehën se ai pa e kuptuar ngaqë kishte përqafuar mendimin modern, kjo do të thoshte perëndimizimi i Islamit.

Për t'i shqyrtuar më mirë marrëdhëniet midis Islamit dhe shkencës moderne, duhet të dijmë mirë diskutimet e filozofisë shkencore që vazhdojnë mbi bazën dhe metodologjinë e mësimave themelore të Islamit dhe shkencës moderne. Është e qartë se sa rreziqe filozofike do t'i sjellë njerëzimit një teori shkencore e paraqitur në formë fetare ose ta sjellësh në një menyrë të padiskutuar sikur të kumtoshe një besim fetar. Përveç kësaj, termat me "bazë" fetare të quajtura "teorike-hipotetike-empirike" është e pakuptimtë të mundohesh t'i shpjegosh apo t'i bësh tema me permbejtje hipotetike dhe kjo gjë do të kishte pasoja. Mirëpo kjo nuk do të thotë që shenjat e "fakteve" të shënuara në Kur'an dhe hadithet e sakta rreth natyrës, njeriut, historisë dhe shoqërisë të cilat hyjnë në shkencat njerëzore nuk do të thotë të mos komentohen në spektrin e shkencës moderne, është e domosdoshme.

Nga ana tjetër, këto komente nuk duhet të bëhen sikur tekstet e Kur'anit dhe hadithet të ishin tekste teorike-shkencore dhe që shkaktojnë anashkalimin e mesazhit bazë apo kuptimin e vërtetë. Sepse Kur'ani ashtu siç nuk është një libër poezish, historie apo filozofije, nuk është as një libër teorik-shkencor. Përtej të gjitha këtyre, ai është një libër udhëzues për të gjitha aktivitetet njerëzore. T'i hapësh rrugën komentimit të ajeteve dhe haditheve nën dritën e akumulimit të vazhdueshëm dhe të ndryshueshëm të shkencës moderne kërkon një metodologji të diskutuar mirë. Ashtu siç për besimin ndaj bazave dhe të vërtetave fetare është normale të jetë i padiskutueshëm dhe i nevojshëm, ashtu edhe teorite shkencore duhet të jenë të hapura për diskutim, testim dhe mosaprovim, ose heqja dorë nga modelet e pavlefshme sqaruese për shkencëtarët. Një shkenctar mund të ketë një besim shkencor për vlefshmërinë e metodës së përdorur prej tij, por nuk mund të presë që të tjerët, ta besojnë si një besim fetar teorinë e tij shkencore. Anasjelltas edhe një dijetar i fesë nuk mund të parashtrorë mësimet fetare pa marrë parasysh të dhënat e shkencës moderne. Sepse një "dijetar" i kohërave tona duhet të jetë personi i parë i cili nuk duhet të mendojë arsimin e njohurive fetare të përfunduara nga shkenca moderne. Sjellja e tij kritike ndaj kësaj teme mund të jetë vetëm në botëkuptimin e parashtruar të një teorie shkencore si një burim për materializmin, pozitivizmin dhe shkencizmin (scientism). Nga ana tjetër, herë pas here intelektual i mysliman bashkëkohor gjen autoritetin të hetojë dhe kritikojë mendimet filozofike të ngritura mbi shkencën moderne, problemet etike dhe ekologjike që mund të shkaktohen. Sepse këto probleme lidhen drejtpërdrejt me termat themelore të fesë tek e cila ai beson.

**Përktheu: Ledian Cikalleshi**

# Dashuria dhe besnikëria ndaj Atdheut

يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِنْ ذَكَرٍ وَأُنْثَىٰ وَجَعَلْنَاكُمْ شُعُوبًا وَقَبَائِلَ لِتَعَارَفُوا ۚ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَلِيمٌ خَبِيرٌ

Në ajetin e lartpërmendur Allahu (xh.sh.) urdhëron e thotë: "O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise që të njiheni me njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush te Allahu është ai që i frikësohet më shumë atij. Allahu është shumë i dijshtëm dhe njeh hollësisht çdo gjë." (Huxhurat, 49:13)

Jemi në festat e nëntorit dhe rrjedhimisht besimtari ka dëshirë t'i shikojë këto ngjarje edhe në këndvështrimin e besimit. Atdhedashuria është një ndjenjë e pastër shpirtërore që instinktivisht gjendet thellë në natyrën e çdo njeriu. Këtë lidhje e mbështetur në besnikëri, vet Zoti e ka mbjellë në trupin e njeriut, në gjenet e tij, në shpirtin e tij që kur e krijoi. Vendi ku lindi, ku lozi, ku u rrit me ushqimin dhe kulturën e tij, ku është njohur me të dashurit e tij, ku kalon vitet e jetës; sigurisht për njeriun ai vend bëhet shumë i dashur. Atdheu në radhë të parë, është pasuri që duhet ruajtur. E ajo pasuri është e gjithanshme, duke futur këtu familjen, gjuhën, traditën, kulturën etj.

Kur dashuria ndaj atdheut mishërohet me besimin në një Krijues, shfaqet në formën më të hijshme, duke sjellë vlera dhe dobi të gjithanshme. Parimi i parë dhe më themelor i fesë Islame, është që fjalët dhe veprat e një personi, kurrsesi nuk duhet të tregojnë hipokrizi apo standarde të dyfishta. Besnikëria e vërtetë kërkon një lidhje të ndërtuar në bazat e sinqeritetit dhe ndershmërisë. Ajo kërkon që edhe nga brenda, njeriu të jetë i njëjtë me atë që shfaqet jashtë. Në marrëdhëniet me kombin, ky parim ka rëndësi të madhe. Prandaj, është thelbësore për një besimtar të vendosë një lidhje besnikërie të çiltër ndaj atdheut të tij.

Deviza islame na mëson se dashuria ndaj atdheut është pjesë e besimit. Ndaj, patriotizmi i sinqertë është një kërkesë e Islamit. Njeriu që shprehet se e do atdheun e tij, është i pajisur me cilësi të larta morale, njerëzore dhe kombëtare. Ai duhet të përpiqet për atdheun e tij në të gjitha drejtimet sipas shkallës

së dijës dhe pozitës. Dashuria ndaj atdheut kërkon prindër të mirë, të cilët i edukojnë fëmijët e tyre në rrugë të drejtë. Kërkon mësues të zellshëm, të cilët i mësojnë nxënësit në formën më të mirë të mundshme. Kërkon punëtorë administrate që u kryen shërbime qytetarëve me korrektësi e gatishmëri. Kërkon hoxhallarë, të cilët përpiqen për ndërgjegjësimin e shoqërisë, duke i lidh njerëzit me fenë dhe atdheun e tyre. Kërkon politikanë, të cilët e përdorin postin për t'i shërbyer mirëqenies së popullit të vet. Kërkon tregtarë e biznesmenë të ndershëm, të cilët synojnë ta çojnë vendin përpara e ta zhvillojnë atë ekonomikisht. Kërkon gazetarë të mirë, të cilët mbrojnë vlerat e popullit dhe i përhapin ato. Kërkon policë e ushtarë vigjilentë që mbrojnë atdheun me dinjitet nga çdo e keqe e mundshme. Pra, dashuria ndaj atdheut kërkon një sensibilizim gjithë-popullorë, e cila nënkupton që interesi i atdheut dhe i shoqërisë të jetë parësor dhe mbi interesat personale.

Në Islam, mbrojtja e atdheut është parim i fesë dhe numërohet si kontribut i shenjtë, i cili shpërblehet shumë nga Zoti (xh.sh.). Pikërisht për këtë, sipas mësimave të islamit, shëhidët-dëshmorët nuk vdesin. Dashuria ndaj atdheut nuk është e barabartë tek të gjithë, ajo është shkallë-shkallë. Por më të këqij janë ata që nuk ndejnë fare përgjegjësi për vendin e tyre, saqë arrijnë të vihen edhe në shërbim të të tjerëve, në dëm të interesave të kombit. Këta konsiderohen tradhtarë dhe do të dënohen si në këtë dynja, ashtu edhe në ditën e gjykimit, dënim i cili do të jetë shumë më i ashpër se i dynjasë.

Ata që nuk e duan atdheun e tyre, ata që punojnë për të keqen e popullit dhe të shoqërisë së vet, ata nuk i do as Zoti Fuqiplotë, siç ka theksuar në Kur'anin Famëlartë: **إِنَّ اللَّهَ لَا يُحِبُّ الْخَائِنِينَ** "Vërtet Allahu nuk i do tradhtarët" (Enfal, 8:58). Apo siç ka thënë Profeti Muhamed (a.s.). "Tradhtarët do të ringjallën ditën e Kiametit të dëshpëruar e të privuar nga mëshira e Zotit".

Islami gjithashtu, na mëson që në asnjë rrethanë, asnjë individ nuk duhet ta marrë vet ligjin në dorë dhe as nuk duhet të marrë pjesë në projekte dhe komplete kundër vendit të tij.



Ky është një urdhër shumë i qartë që vjen nga Islami. Islami na mëson se njerëzit që ndjekin këto rrugë, nuk mund të shpresohet të tregojnë besnikëri, sepse besnikëria është e gërshetuar me virtytet e larta. Besnikëria nuk mund të ekzistojë pa vlerat e larta morale dhe vlerat e larta morale nuk mund të ekzistojnë pa besnikëri. Besnikëria ndaj atdheut kërkon që njeriu të tregohet i virtutshëm, i duruar dhe zbatues i ligjeve të vendit. Prandaj, është e pamundur që dashuria e një myslimani ndaj Zotit, të mund të bëhet pengesë për të shprehur dashurinë dhe besnikërinë ndaj atdheut të tij.

Dashuria për atdheun është instinkt te njeriu. Është instinkt i mbjellë në shpirtin, e cila e bën njeriun të qetë kur qëndron aty dhe mallëngjehet për të kur është larg tij. Sado që njeriu të dëshirojë të largohet prej atdheut, dëshira për kthim mbetet përherë e varur në kujtesën e tij. Profeti Muhamed (a.s.) u detyrua të emigrojë nga Meka në Medinë. Një shenjë e dashurisë ndaj vendlindjes, ishte kur ai ktheu kokën edhe njëherë për të shikuar Meken dhe tha: "Sa vend i bukur që je, sa e dashur më je! Sikur populli yt të mos më nxirrnin me dhunë prej teje, kurrë nuk do të kisha banuar diku tjetër". (Buhariu)

Buhariu transmeton se kur një i ditur, Uereka b. Neufel, i tha Muhamedit (a.s.) se, në çastet e para të profetësisë populli yt do të torturojë, do të mundojë, do të bojkotojë, do të luftojë, do të tallë, do të shajë, do të largojë nga vendi, këtu Profeti ndaloi se i dhembti, dhe i çuditur pyeti: "Pse, a do të më nxjerrin me forcë?!" Uereka ia ktheu: "Po, nuk ka ardhë asnjë njeri me këtë që erdhe ti, e të mos jetë persekutuar. Nëse më zë dita jote, do të të ndihmoj."

Ashtu siç donte Meken e nderuar, pas vendosjes në Medinë, gjithë kontributin e tij Profeti e kishte përqendruar në atdheun e dytë. E luste Allahun që ta pajisë me dashuri për të, në këtë mënyrë: "O Allahu ynë! Na e bëj Medinën të dashur, ashtu siç e duam Meken, apo edhe më shumë." (Buhariu) Profeti ynë, aq shumë e donte Medinën, sa që kur dilte për ndonjë luftë apo udhëtim mallëngjehej shumë për të. Buhariu transmeton nga Enesi se kur Profeti Muhamed (a.s.) kthehej prej ndonjë udhëtimi dhe afrohej afër Medinës, aq sa shihte rrugët, pemët

apo muret e saj, e nxiste devenë ose kalin të nxitonte. Kjo vinte pikërisht nga dashuria që ai ndiente për të.

Bazamenti i atdhetarizmit në Islam është besimi, e kurrësi fanatizmi racor apo kombëtar. Atdhetarizmin që Islami e refuzon është ai racor, grupor, i cili ummetin dëshiron ta ndajë në grupe të dobëta, që urrejnë njëra tjetrën dhe shajnë e fyejnë në vend që të ndihmohen e të përkrahen. Thotë Profeti Muhamed (a.s.): "Nuk është më i mirë arabi ndaj joarabit, përveçse me devotshmëri". (Ahmedi)

Në këtë kohë, vërejmë që bota është bërë si një fshat global. Popujt e të gjitha kombeve, feve dhe kulturave gjenden në të gjitha shtetet. Kjo kërkon që liderët e çdo vendi të vlerësojnë dhe respektojnë ndjenjat dhe mendimet e të gjithë njerëzve. Padrejtësitë dhe egërsitë duhet të eliminohen dhe në vend të tyre duhet të mundohemi për të vendosur drejtësinë e vërtetë. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë, është që bota të arrijë t'a njohë Krijuesin e saj. Çdo lloj besnikërie, duhet të lidhet me besnikërinë ndaj Zotit. Nëse do të ndodhë kjo, atëherë me sytë tanë do të mund të dëshmojmë tek njerëzit e të gjitha vendeve, nivelet më të larta të besnikërisë. Njëkohësisht do të hapen rrugët më të reja që na çojnë drejt paqes dhe sigurisë në mbarë botën.

Dashuria dhe besnikëria ndaj atdheut që pretendojmë, kërkon edhe sakrificë për të, kërkon kontribut të vazhdueshëm për t'i sjellë atij çdo të mirë dhe për të larguar prej tij çdo të keqe. Shqiptari e ka treguar dashurinë ndaj atdheut të vet brez pas brezi dhe ka përballuar shumë stuhi gjatë jetës së tij për liri. Shumë prej tyre kanë rënë në fushën e betejës dhe kanë marrë titullin e dëshmorit apo të shehidit. Besimtarët atdhedashës janë njëkohësisht edhe besimtarë besnik e të devotshëm, sepse nuk lejojnë që t'u preket feja dhe besimi i tyre, si dhe të merret nëpër këmbë atdheu.

Duke mbrojtur fenë islame, ne mbrojmë atdheun, sepse të mbrosh atdheun do të thotë të mbrosh dinjitetin tënd, të familjes tënde dhe atë kombëtare. Zoti na e shtoftë dashurinë dhe besnikërinë për atdheun.



# *Dhuna në familje* **dhe qëndrimi i Islamit ndaj këtij fenomeni**



Kur Zoti krijoi femrën, Ai e krijoi atë si gjysmën tjetër plotësuese të mashkullit, si bashkudhëtare, shoqe me të cilën do të përballonte sfidat e shumëllojshme të kësaj bote. Ata do të ishin të barabartë në natyrën që ishin krijuar. Kur Zoti vendosi të krijonte gruan, Ademin a.s. e vuri në gjumë, mori njërën nga brinjët e tij dhe krijoi gruan e parë, Havanë. Kur Ademit a.s. i doli gjumi, gjeti një grua pranë tij. Ai e pyeti menjëherë: "Kush je ti?" Ajo u përgjigj: "Jam një grua." Ademi a.s. e pyeti: "Përse je krijuar?" Havaja iu përgjigj: "Që të gjesh prehje tek unë."

Vetë Allahu në Kur'an në lidhje me krijimin e mashkullit dhe femrës si dhe marrëdhënien mes tyre, thotë: "O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu të vetëm, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra... Jetoni e silluni mirë me to!" (Nisa, 1 dhe 19)

Por sa keq. Me kalimin e viteve, gruan e hodhën nga piedestali mbi të cilin e kishte vendosur Krijuesi. Ajo u pa si një krijesë e dobët, si plaçkë a send në dorën e mashkullit, me të cilën ai mund të bënte ç'të donte. Të drejtat e shkelura të gruas dhe dhuna ndaj saj janë kthyer në njërën prej plagëve më të rënda të shoqërisë kudo, së cilës nuk po i gjendet shërimi. Në Traditën Profetike na tregohet një shembull shumë i mirë në lidhje me të.

Në Sunenin e Ebu Davudit transmetohet një ngjarje shumë interesante, nga e cila mund të nxjerrin shumë mësim si myslimanët, por edhe njerëzit e tjerë. Profeti Muhamed a.s. u kishte thënë shokëve të tij në lidhje me gratë: "Mos i qëlloni robërshat e Zotit!" Disa kohë pasi Profeti a.s. e kishte thënë këtë hadith, shkon Omeri r.a. dhe i thotë: "O i dërguar i Allahut! Gratë po iu kundërvihen burrave!" Atëherë Profeti a.s. i lejoi burrat që t'i edukojnë gratë e tyre. Menjëherë pas kësaj, shtëpia e Profetit a.s. u mbush me gra që ankoheshin për burrat e tyre. Profeti a.s. tha: "Në shtëpinë e Muhamedit kanë ardhur shumë gra që

ankohen për burrat e tyre. Ta dinë se ata burra nuk hyjnë te fisnikët myslimanë."

Pra, Profeti i mëshirës i urdhëron shokët e ndjekësit e tij të mos i qëllojnë gratë. Përdorimi i fjalës "robërshë", përcjell një mesazh të rëndësishëm, i cili mund të përkthehet në: "Një robërshë ose rob e qëllon, dënon ose liron vetëm pronari i saj/tij, jo dikush tjetër". Pra, gratë edhe burrat kanë "pronar" Zotin e Madhëruar dhe nuk mundet dikush tjetër të vërë dorë mbi "pronën" e Tij.

Pasi Profeti a.s. u jep leje burrave t'i edukojnë gratë e tyre dhe ato ankohen për mënyrën si burrat vepronin, ai i pranon ankesat e grave dhe u tërheq vëmendjen burrave të mos e bëjnë më diçka të tillë.

Kur Profeti a.s. u pyet mbi të drejtat e gruas, u përgjigj: "Ta ushqesh siç ushqehesh, ta veshësh siç vishesh, të mos e qëllosh në fytyrë, të mos përdorësh me të fjalë banale dhe të mos e braktisësh, veçse në shtëpi." Profeti a.s. në këtë hadith i garanton gruas të drejtat e saj themelore, dinjitetin dhe sërish urdhëron që gruaja të mos goditet.

Në lidhje me të drejtat e gruas dhe ndalimin e dhunës në familje në Islam mund të gjejmë shembuj të shumtë, por shembulli më i goditur dhe më i duhur, që e bën një burrë të çfarëdolloj përkatësie fetare, kombësie apo race t'i vërë gishtin kokës, është fjala e Profetit a.s.: "Si mund ta qëllojë dikush prej jush të shoqen ashtu siç qëllon skllavin? Si është e mundur që e qëllon ditën, e mandej shkon dhe shtrihet me të në shtrat në darkë?" Ai a.s. nuk e imagjinonte dot se si një burrë mund të shtrihej në mbrëmje për të fjetur me të shoqen, nënën e fëmijëve të tij, të cilën e kishte qëlluar e goditur.

Në fund, do të doja të përmendja sërish fjalët e bukura dhe lakonike të Profetit Muhamed a.s. me të cilat ai bëri të reflektonte një të ri, i cili mëkatonte: "A do të dëshiroje që dikush t'ia bënte këtë nënës tënde, motrës tënde, vajzës tënde, e po edhe ajo grua është nëna, motra apo bija e dikujt!"

# 28 NËNTOR 1912



28 Nëntor 1912! Ditë vjeshte. Qielli mbuluar me re të rënda, plot shi. Në mëngjes, retë sitin një shi të hollë e të dendur që depërton gjer te kockat e kurrizit. Tregtoret janë mbyllur: festa duket ndër syt' e njerëzve të mbledhur këtu e atje: të gjithë bisedojnë rëndësinë e ditës dhe të mirat që premtan ngjarja e madhe e shpalljes së lirisë.

Minutat kalojnë tepër ngadalë: të gjithë e presin me padurim orën e mbledhjes. Koha e hapjes së kuvendit është caktuar më 3:30, por të dërguarit e popullit nisën që më tre t'i zënë fronat radhura rreth sofrës së gjatë në sallën e jashtme të shtëpisë së Xhemil Beut. Njëri

pas tjetrit hyjnë shumë burra t'ardhur për këtë ditë nga gjithë viset e tokës shqiptare. Geg' e Toskë, Muhamedanë e të Krishterë, delegatë të Kosovës e të Çamërisë, të Bregut të Detit e të Shkodrës jetike, të Korçës së bukur e të Malësisë së Gjakovës. Të gjitha krahinat janë përfaqësuar.

Më tre e gjysmë hapet mbledhja. Salla është plot. Në krye të sofrës rri Ismail Qemali. Kurrë s'është dukur më i ri. Fytyra e tij e ëmbël fiton, me të parë, zemrat dhe nderimin e atyre që e qarkojnë. Mjekra e bardhë si dëbora i stolis faqet plot shëndet. Sytë e kulluar tradhtojnë me shkëlqimin e tyre, gëzimin e thellë që ndien



zemra në këtë çast të madh për historinë e kombit.

Afër tij është Don Kaçorri. Gjithmonë buzëqeshur, sytë e tij shumë të lëvizshëm kërkojnë miqtë ndër të gjitha këndet e sallës për t'u thënë atë "n'jatjeta" për të cilën i ndjeri kish një theksim të veçantë. Aty pranë gjendet dhe Luigj Gurakuqi, i cili në këtë çështje është, me të vërtetë, "dora e djathtë e Plakut".

Midis gjithë të tjerëve që kanë një emër më shumë a më pak të famshëm, tërheq vëmendjen fytyra e Isa Buletinit. Në fytyrë e në shtat Isa "Begu" përmbledh vetijat e shqiptarit jo më pak në jetën e tij shpirtërore. Të pamët luftëtari, gjithmonë i vrenjtur, kurrë s'i qesh buza pa shkak të rëndë. I gjatë dhe i hollë, trupi është lidhur me dej të hekurt. Dëgjon shumë dhe flet pak; s'përzihet në fjalën e tjarit, dhe, kur flet, s'ngutet. Ai s'qe njeriu i fjalës, por i punimit a, më mirë, i pushkës. Mund të thuhet për Isa Buletin vargjet që i ka kushtuar At Fishta Marash Ucit:

*Arm't i kjen baba e nana;  
Bab' tagani e nan' breshana;  
Vlla e motër dy pistollet;  
Dy gjarpnusha prej Stambollet.*

Por askush nuk mund të shikojë Isa Begun, pa vënë re edhe plakun që i rri mbas. Është Babë Dud Karbunara, delegat i Beratit. Mjekra e tij e gjatë dhe e rrallë e tregon, midis të tjerëve, si një fytyrë të huaj. Me një shami të kuqe i fshin, fshehurazi, lotët që rrjedhin kundër vullnetit të tij. Qysh të mos qajë i mjeri plak? Zemra e tij s'mund ta përfshijë gjithë gëzimin e kësaj dite. Një jetë të gjatë e priti këtë çast, për të cilin kish predikuar pa dëshpërim dhe tani e sheh me sy! "Të të falem, o Zot! – thotë Baba Duda. – Për këtë ditë i lutesha Zotit të ma zgjaste jetën. Tani e pashë: mund t'i mbyll sytë..."

Kish kaluar ora nga tre e gjysmë kur u ngrit Ismail Qemali dhe, ngadalë, me kthjelltësi, tregoi qëllimin e mbledhjes. Përshkrimi i vuajtjeve të shumta të popullit shqiptar nën zgjedhë, përban pjesën e parë të fjalës së kryetarit. Pastaj foli për shtetet e tjera të Ballkanit, qysh u liruan dhe qysh rrojnë dhe përparojnë. Këto fituan miqësinë e shteteve të mëdha dhe rritën fuqinë e tyre aq sa i shpallën luftë Turqisë dhe po e mundin. Po ata s'duan të pushtojnë vetëm viset që janë të tyre. Lakmia e tyre është pa masë dhe përfshin gjithë trashëgiminë e Turqisë në Ballkan, pra,

dhe Shqipërinë. Veriga që e mbajti të lidhur Shqipërinë me mbretërinë e Sulltanëve me shumë se 400 vjet, sot është e këputur. Kombi shqiptar, që ka dërguar këtu kaq përfaqësorjës të ndershëm a mund të durojë të hyjë nën një skllavëri të re, më të keqe se të parën?

"Kurrë" e "kurrnjëherë" është përgjegja e shpejtë që del nga goja e të gjithë burrave.

Dhe Ismail Qemali mbaron duke thënë këto:

Populli shqiptar na zgjodhi e na dërgoi në këtë mbledhje që të këshillohemi për shpëtimin e Atdheut. Shpëtimi është një i vetëm: Liria. Prandaj, duke u mbështetur mbi të drejtat e shenjta dhe mbi dëshirën e vullnetit e patundur të gjithë popullit, na, përfaqësorjës të tij, e shpallim Shqipërinë mbretëri më vehte, të lirë e të pavarur... Të gjithë janë në këmbë. Një "Rroftë Shqipërija" e "Rroftë Shqipërija", që del prej të gjithë krahavorëve mbulon fjalët e fundit të Ismail Qemalit. Urimet përsëriten e më s'marrin fund. Një flamur u shfaq në atë çast në mes të odës. Një tjetër flamur i rrëfëhet në dritare popullit që ishte mbledhur në oborr të shtëpisë. Gëzimi ish përshkrojtur nëpër të gjitha fytyrat. Shumë qanin. Qysh mund t'i mbanin lotët duke parë një skenë të tillë: Shqiptarë prej të gjitha viseve, që kurrë s'janë parë njëri me tjetrin; njerëz të cilët gjer dje duke patur fe dhe fis të ndryshëm, shikoheshin si të huaj dhe sot... sot, pas qindra vjetësh, kuptojnë përsëri se janë vëllezër që s'mund të kenë veç një qëllim: Të bashkuar, të mbrojmë nderin e asaj nëne që ka bashkuar sot rreth saj, rreth Flamurit të kuq me shqipen e zezë...

I tëri qyteti kremton. Të gjithë shikojnë me shpresë kohën e pastajme dhe telegrafi i lajmëron botës lindjen e një Shteti të ri.

Dhimitër Berati

Revista "Njeriu", Nr. 5, 1942: 8.

### Flamuri

Flamuri përmbledh kujtimet e shkuara të një kombi në një gjuhë të pashkruar që mund ta kuptojë syri dhe zemra e çdo njeriu me ndjenja.

Cilat janë kujtimet që shfaq duke vuar, Flamuri ynë? Nuk janë kujtime goditjesh kundra fqinjëve, nuk janë kujtime lakmish edhe rrëmbimesh: janë kujtime vetëmbrojtjeje me mundime të palodhura dhe me trimëri të gjata e të forta që kanë lënë gjurmë në letërsinë e gjithë popujve të qytetëruar. Nga kjo pikëpamje Flamuri ynë, siç është një ata më të vjetrit e botës, është dhe një nga më të drejtët.

# Kujtime nga rihapja e lirisë së besimit në Shqipëri



## Xhamia e Plumbit

Xhamia e Plumbit, ose xhamia e Mehmet pashë Bushatliut, i përket vitit 1182 h (1768)

Xhamia me një sallë mjaft të madhe, me një kube të vetme të madhe, është e shtuar me një mihrab (vendfajla e imamit) magjepsës me një kube katërqoshesh ose gjysmërrethi. Në secilën faqe të kasnakut tetëqoshesh ka nga një dritare. Dritaret nuk bien në sy ngaqë janë të mbuluara me një çardak tresh që është vazhdim i vendit të xhemit të fundit...Xhamia është bërë plotësisht prej guri të gdhendur.

Vendi i xhemit të fundit dhe pjesa e brendshme e mureve është prej guri shtuf. Shtyllat janë prej mermeri masiv, kurse kokat e tyre, të stilit rokoko...

Xhamia e Plumbit – Monumenti historik më i bukur ndër të gjithë objektet e tjera të lagjes "Tabakë", ndërtesë madhështore e artistike, në stilin arabo-turk që ka tërhequr interesimin e vizitorëve. Kjo xhami i kujton vizituesit begatinë e dikurshme të lagjes "Tabakë" dhe të të tjerave përreth kalasë.

Kjo xhami ka diçka të veçantë nga xhamitë e tjera të Shkodrës. Ndoshta është shpirti i historisë së saj ai që të tërheq e të bën për vete sapo takohesh me të dhe hyn në ambientet mjaft tërheqëse që ka kjo faltore shumëshekullore në vendin tonë. Ndoshta është shpirti islam i paraardhësve tanë dhe mesazhet e pastra të njësimi të Krijuesit të gjithësisë që gjejmë brenda kësaj xhamie, si një hallkë e qëndrueshme dhe e fortë që lidh realitetin tonë me atë të baballarëve tanë besimtarë. Ndoshta është pozita e saj strategjike

në hyrje të qytetit, bri kalasë, pranë Drinit, në një prej lagjeve më të vjetra të qytetit, ku ambienti përreth bie erë historie e zgjon nostalgji kohërash e njerëzish që i dhanë emër këtij qyteti dhe u kthyen në një mozaik vlerash për të...

## 16 nëntor 1990

"...një grup qytetarësh, shumica të rinj si: Pëllumb Sallku, Bice Myftia, Agron Dibra, Abdullah Myftia, Eljaz Pateriku, Mithat Myftia, Gani Kryeziu, Faik Zaganjori, Mevaïd Tresi, Qamil Nikshiqi, Minir Loku, Ibrahim Bilali, Ferid Lluja, Rasim Sokoli, Halil Veli Dani, Abedin Qallimi, Ferid Hajdari, Rauf Karakaçi e të tjerë morën iniciativën e guximshme për të hapur xhaminë, për të falur xhumanë, për të ripërtërirë fenë, për të rifituar të drejtën e ushtrimit të lirë të besimit fetar...

Një rol të rëndësishëm në këtë veprimtari me fjalën e rastit e me drejtimin e besimtarëve për të falur xhumanë, ka luajtur Hafiz Sabri Koçi, i cili u bë simbol i përtëritjes së fesë islame në Shqipëri.

Duke kujtuar këtë ngjarje të shënuar historike, na del përpara ai miting i madh popullor me rreth 60.000 pjesëmarrës nga qyteti e fshati, nga të gjitha moshat...

Kjo ngjarje e paharruar jehoi në çdo familje, ajo u bë nxitje për të ndërmarrë vepra të tjera në dobi të gjallërimit të fesë, për të kapërcyer atë periudhë terri ateist 50 vjeçar."

Hafiz Sabriu ka thënë: "Gëzimi më i madh imi ka qenë më 16 nëntor...sikur linda përsëri. Kur shkova te xhamia,

ç'të shihja? Ishte mbushur zi me njerëz. Vargu i tyre zgjatej deri në kala. Altoparantët rreth e përreth...

Të gjithë filluan të bënin tekbir. Brohoritnin. Masa gjithnjë e më tepër merrte flakë...Kam hipur në një tribunë të ngritur për atë qëllim. Mezi e përmbajta veten dhe s'mundja t'ju besoja syve të mi...S'kisha parë në jetën time aq të tubuar, mbi 55 mijë vetë...E pashë veten aq të lumtur, saqë nuk kisha gajle edhe sikur të bija kurban. Nuk kishte gëzim më të madh për jetën!"

Rahmete dhe respekt për të gjithë ata besimtarë të përkushtuar që kontribuan me pasurinë dhe shpirtin e tyre për skalitjen e datës 16 Nëntor 1990 në kujtesën historike të kombit shqiptar!

### **Formimi i Bashkësisë Islame të Shqipërisë**

Ndërsa mitingu madhështor përfundoi dhe njerëzit tuba-tuba po shpërndaheshin, duke mbartur me vete gëzimin e harenë e asaj dite të madhe, në Xhaminë e Plumbit u organizua shpejt e shpejt një mbledhje për nga përmasat, por me një rëndësi të veçantë historike për të ardhmen e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Në këtë mbledhje, si të themi në ilegalitet, u vendos krijimi i "Bashkësisë Islame Shqiptare" me qendër në Shkodër.

### **Nuk u besonim syve tanë**

Shkodra, qytet mijëravjeçar, shkëmb i qëndresës dhe vatër e kulturës shqiptare në shekuj. Qyteti i Teutës, Gentit, Barletit, Kara Mahmud Pashës, Shesh Shamisë, Hafiz Ulqinakut, Oso Kukës, Hodo Sokolit e shumë e shumë të tjerëve, po shkel në pranverën e demokracisë.

Shkodra, fortesa më e pathyeshme e dinjitetit, e trashëgimisë, e besimit fetar në Shqipëri, luftoi me të madhe për ta ruajtur dhe për ta mbajtur të gjallë në zemrat e njerëzve dashurinë ndaj të Madhit Zot. Kështu pas një çerek shekulli shtypje, mohim i të drejtave të pamohueshme të njeriut për të jetuar dhe besimin fetar të ndaluar e të shkatërruar padrejtësisht nga ateizmi më ekstrem komunist, i cili i shfaqti shpifjen më të rëndë ndër shekuj popullit shqiptar duke e quajtur "ateist". Merta për këtë korrigjim fillimisht i takon rinisë shkodrane e cila pa u hamendur e trasoi rrugën në tërë vendin. E riktheu besimin, njerëzoren, fenë. Me këtë rast u vërtetua thënia a ajeti i Kuranit: "Ne e kemi zbritur atë (Kuranin) dhe Ne do ta ruajmë atë", dhe vërtet, këtu nën trysninë më të madhe e ruajtëm Kuranin në zemrat tona. Tamam në ditën e xhumasë më 16 nëntor 1990, hirësia e tij Hafiz Sabri Koçi bëri inaugurimin, rihapjen e Xhamisë së Plumbit, këtij monumenti të kulturës dhe historisë shqiptare, që sot është e vetmja xhami e mbetur nga 36 xhamitë sa kishte Shkodra. Kjo e dhënë



Sabri Koçi, i cili deklaroi rihapjen e Xhamisë së Plumbit dhe njëkohësisht mundësoi shpërthimin e ndjenjave fetare të shqiptarëve për 25 vjet. Kjo skenë që do t'i kishte befusuar edhe regjisorët më të njohur bëri që të emocionohen edhe mbi 55.000 njerëz të tubuar. Pleqtë bënin dua dhe nuk mund t'i mbanin lotët që edhe një herë e përjetuan këtë ditë që vetëm një muaj më parë iu dukej ëndërr, ishte "mollë e ndaluar" dhe nuk bëhej asnjë tolerim. Në anën tjetër shumë të rinj, fjalëpakë por punëshumë, ishin të vendosur se vetëm në rrugën e Zotit do të jetë e ardhmja e njerëzimit, gjersa fëmijët, brezi më i privilegjuar ndjehej aq fatlum sepse atij do t'i takojë e ardhmja dhe detyra për ta çuar përpara këtë rrugë të filluar nga stërgjyshërit e tyre.

Hafiz Sabri Koçi dukej si djalë i ri plot emocione e përmalluar në vete (duke rikujtuar vuajtjen dhe tmerrin), po gjen ngushëllim kreu vëren masën e tubuar e cila nuk e ka humbur dashurinë për të dhe për fe. Dhe ja me një ton plot energji fillon ta falënderojë Allahun xh.sh. që na e bëri të mundur përsëri të shohim këtë ditë, pastaj nga zemra falënderon rininë shkodrane që me bindje e besim tek i Madhi Zot e solli këtë rast, që bëri jehonë thekshëm në tërë vendin.

Nga kubet e bardha të kësaj Xhamie pas shumë vjetësh u dëgjuan versetet e Kuranit dhe Hadithet e Muhamedit (a.s.) të cilat me besnikërinë më të madhe i kishte ruajtur në memorien e tij Hafiz Sabriu. Përmbajtja e tyre mund të përmbledhet në thirrjen e njerëzimit për paqe, dashuri, harmoni, mirëkuptim, bashkëpunim, miqësi, vëllazërim midis njerëzve pa dallim.

Kjo ditë do të kujtohet ndër breza, si ditë që shënoi një etapë të re, të ndritshme.



# Ndikimi i Islamit në mjekësinë botërore I

Pjesa e parë

Mjekësia islame: 1000 vjet më parë<sup>\*1</sup>

Për më shumë se 1000 vjet, Perandoria Islame vazhdoi të ishte bashkësia më e përparuar dhe më e qytetëruar në botë<sup>\*\*2</sup>. Kjo sepse Islami e vuri theksin te rëndësia dhe respekti për dijen, sepse ndaloi shkatërrimin, sepse zhvilloi te myslimanit respektin për autoritetin e disiplinën dhe tolerancën për fetë e tjera. Myslmanët e njihnin përsosurinë dhe etjen për dije. Por, nga shekulli X, zelli dhe entuziazmi i tyre për dije bëri që të gjitha shkrimet mjekësore kryesore greke të përktheheshin në arabisht në Damask, Kajro dhe Bagdad. Arabishtja u bë gjuha ndërkombëtare e dijes dhe e diplomacisë. Shekulli i dijes dhe i veprimtarisë shkencore u zhvendos drejt Lindjes dhe Bagdadi u bë kryeqyteti i botës shkencore. Myslmanët u bënë novatorë shkencorë me origjinalitetin dhe prodhimtarinë e tyre.

Mjekësia islame është një nga tiparet më të famshme dhe më të njohura të qytetërimit islam dhe ku myslimanët kanë shkëlqyer më shumë. Myslmanët qenë pishtarëmbajtësit e mëdhenj të kërkimit shkencor ndërkombëtar. Ata e goditën topin e dijes mbi gardhin e Europës. Sipas fjalëve të Kembellit, "Sistemi mjekësor i Europës është arab jo vetëm për

nga origjina, por edhe për nga struktura. Arabët janë paraardhësit intelektualë të europianëve".

Shkollimi mjekësor: Në vitin 636 të erës sonë, qyteti persian, Xhundi - Shapur, që do të thoshte

"kopshti i bukur", "u pushtua" nga myslimanët me universitetin dhe spitalin e madh. Më pas u ngritën shkollat mjekësore islame sipas modelit Xhundi - Shapur. Shkollimi mjekësor ishte serioz dhe sistematik. Leksionet dhe sesionet klinike mbështeteshin në praktikën. Këshilla që u jepte Ali ibnul - Abbasi (Ali Abbas: 994, era jonë) studentëve të mjekësisë është po aq e kohës edhe sot. Për studentin e mjekësisë ishte e detyrueshme të ishte vazhdimisht i pranishëm në spital bashkë me profesorët më të mirë të mjekësisë, të tregonte kujdes të përhershëm për kushtet e të sëmurëve dhe të pyeste vazhdimisht për gjendjen e tyre dhe simptomat e sëmundjeve, duke ruajtur në mendje çfarë kishte lexuar për to dhe çfarë tregonin ato: mirë apo keq. Raziu (841 - 926, era jonë) i këshillonte studentët e mjekësisë, kur vizitonin një të sëmurë, të kishin në mendje simptomat klasike të sëmundjes dhe t'i krahasonin ato me simptomat e gjetura prej tyre.

Mjekët më të zotë, të tillë si, Raziu, Ibn Sina (Avicena: 980 - 1037, era jonë) dhe Ibn Zuhr (Avenzoar: 1116, era jonë) kryenin edhe detyrën e drejtorit të spitalit edhe të dekanit të shkollave mjekësore. Ata ekzaminonin të sëmurët dhe ua paraqisnin studentëve çfarë ekzaminonin. Anamneza klinike (historiku i sëmundjes) shkruhej dhe ruhej për ta paraqitur në leksion. Në spital mbaheshin regjistra. Në Bagdad, anatomia mësohej duke hapur majmunët, duke studiuar skelete, etj.

Alkimia ka qenë dikur kërkesë e domosdoshme për t'u pranuar në një shkollë mjekësore. Studimi i bimëve mjekësore dhe shkenca për barnat ishin ndër lëndët e shkollimit bazë. Shumë spitale kishin kopshte bimore si burim për barna për të sëmurë dhe si mjet mësimi për studentët. Shumica e leksioneve mbështeteshin në farmakologji e toksikologji dhe në përdorimin e antidotëve (kundërhelmeve). Gjatë trajnimit klinik, studentët ndaheshin në grupe të vogla pranë mjekëve të njohur dhe me eksperiencë për vizita në pavijone, diskutime, leksione etj.

Në kurrikula, theksi vihej te qartësia e shkurtësia e

1. \*Botohet me shkurtime. (redaksia)

2. \*\*Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të cilin M. Hart, dijetar hebre, e rendit të parin në librin e tij, "The 100: The Most Influential Persons in History" (100 njerëzit më me influencë në histori), mundi t'i bashkonte fiset arabe, të përçara nga hakmarrjet, rivalitetet dhe luftërat ndërmjet tyre dhe të formonte një bashkësi të fuqishme e të sundonte njëherësh dy perandoritë e njohura të kohës - Perandorinë Persiane dhe Perandorinë Bizantine. Perandoria Islame shtrihej nga Oqeani Atlantik në Perëndim e deri në kufi me Kinën në Lindje. Vetëm 80 vjet pas ndarjes së Profetit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nga kjo jetë, myslimanët kaluan në Europë, për të sunduar Spanjën për më shumë se 700 vjet. Myslmanët i ruajtën kulturat e vendeve të sunduara dhe sollën kulturë e shkencë në to. Sidoqoftë, kur u dobësua Perandoria Islame, pjesa më e madhe e kontributeve islame në kulturë e në shkencë u shkatërrua. Mongolët dogjën Bagdadin (më 1258 të erës sonë) me barbarinë e tyre; kurse spanjollët, me urrejtjen e tyre shkatërruan pjesën më të madhe të trashëgimisë islame në Spanjë.

përshkrimit të sëmundjes dhe veçimi i një sëmundjeje nga një tjetër. Deri në kohën e Ibn Sinës, përshkrimi i meningjtit ngatërrohej me infeksionin akut që shoqërohej me delir. Ibn Sina i përshkroi simptomat e meningjtit me kaq qartësi dhe saktësi, sa mund të ketë mbetur shumë pak për të shtuar pas 1000 vjetësh. Kirurgjia përfshihej në kurrikula. Pasi mbaronin shkollën, disa studentë specializoheshin nën udhëheqjen e specialistëve të njohur. Disa të tjerë specializoheshin qysh gjatë trajnimit klinik.

Në shkollë mësoheshin shumë operacione, të tilla si, prerja e një gjymtyre (amputimi), operimi i venave varikoze (variceve) dhe i hemorroideve. Ortopedia mësohej gjerësisht dhe përdorimi i allçisë në fraktura (thyerje) u tregohej vazhdimisht studentëve. Kjo metodë e trajtimit të frakturave u zbulua në Perëndim më 1852. Trajtimi kirurgjikal i perdes së syrit (kataraktit) ishte shumë i zakonshëm. Obstetrika u qe lënë mamive. Specializantët konsultoheshin me njëri-tjetrin dhe me specialistët.

Ibn Sina dhe Haziu, të dy merreshin gjerë me psikoterapinë dhe ua mësonin psikoterapinë studentëve dhe specializantëve. I diplomuari në mjekësi nuk mund ta ushtronte profesionin pa marrë provimin e licencimit. Vetëm në Bagdad, në vitin e parë të urdhrit për licencim, hynë më se 860 veta. Komisionet e licencimit kryesoheshin nga një nëpunës qeveritar, i quajtur mutasib, ose nga një inspektor i përgjithshëm. Mutasibi kontrollonte, gjithashtu, peshat dhe masat e tregtarëve dhe të farmacistëve. Kishte farmacistë që ishin punësuar si inspektorë, për të kontrolluar barnat dhe cilësinë e barnave në një farmaci. Ajo që bën sot Food and Drug Administration (FDA) (Administrimi i Ushqimeve dhe i Barnave) në Amerikë, është bërë në mjekësinë islame para 1000 vjetësh. Në qoftë se mjeku i ri kalonte me sukses provimet e licencimit, mutasibi i kërkonte betimin e Hipokratit dhe i lëshonte licencën. Në Perëndim, sidomos në Amerikë, pas 1000 vjetësh është zbatuar licencimi i mjekëve me anë të Komisionit Shtetëror të Licencimit në Mjekësi (State Licensing Board in Medicine).

Shkollat mjekësore europiane ndoqën modelin e shkollave mjekësore islame. Në fillim të shekullit XIX, studentët e Universitetit të Sorbonës nuk mund të diplomoheshin pa lexuar "Kanunin" e Ibn Sinës.

Spitalet: Spitalet u shërbenin qytetarëve falas dhe pa dallim ngjyre, feje, gjinie, moshe, ose gjendjeje shoqërore. Spitalet administroheshin nga qeveria. Drejtorët e spitaleve ishin mjekë. Spitalet kishin pavijone të veçanta për meshkuj dhe për femra. Secili pavijon kishte personelin e infermierëve. Për sëmundje të veçanta (ethe, plagosje, infeksione, mani, ftohje, diare, çrregullime femërore etj.) kishte pavijone të veçanta. Brenda tyre ishte konvalishenca. Kishte ujë pa kufizim dhe banjë për t'u larë. Vetëm mjekët e kualifikuar dhe të licencuar lejoheshin me ligj të ushtronin mjekësinë. Spitalet kishin

farmaci që jepnin barna falas për të sëmurët, sallat e tyre të konferencave dhe bibliotekat, me librat më të fundit.

Spitali i Tulumit, i ngritur në Kajro më 872 të erës sonë, kishte 100 mijë libra. Universitetet, qytetet dhe spitalet kishin biblioteka të mëdha; p.sh., Universiteti "Mustansiria" në Bagdad kishte 80 mijë vëllime; biblioteka e Kordovës, 600 mijë vëllime; ajo e Kajros 2 milionë dhe ajo e Tripolit 3 milionë. Mjekët kishin koleksionet e tyre të librave, në një kohë kur shtypja e librave nuk njihej dhe libri shkruhej me dorë nga shkruer të zotë dhe të specializuar. Për të parën herë në histori, këto spitale mbajtën të dhëna me shkrim për të sëmurët dhe mjekimin e tyre.

Nga pikëpamja e trajtimit mjekësor, spitali ishte për të sëmurë të shtruar dhe për të sëmurë ambulatorë. Sistemi spitalor për të sëmurë të shtruar ishte me fare pak dallime, njëlloj si sot. Kur dilte nga spitali, çdo të sëmurë i jepeshin pesë florinj për të mbajtur veten derisa të rifillonte punën.

Spitalet kishin dhoma elegante dhe biblioteka të mëdha. Pavijonet ishin të mëdha, kishin dhoma pritjeje për vizitorët dhe të sëmurët. Në Damask kishte spital të veçantë për lebrozët, kurse në Europë, edhe gjashtë shekuj më pas, me një vendim mbretëror, lebrozët digjeshin. Në burgje bëheshin vizita të rregullta nga mjekët. Në një kohë kur Parisi dhe Londra ishin vende me rrugë me baltë dhe kolibe, Bagdadi, Kajroja dhe Kordoba kishin spitale me risi që sot duken, vërtet moderne. Spitalet islame shkëlqyen me humanizmin e tyre, me kujdesin për të sëmurin. Afër pavijoneve të etheve, kishte shatërvanë që freskonin ajrin; të çmendurit trajtoheshin me butësi e dhembshuri; natën, muzika dhe tregimet qetësonin të sëmurët.

Spitalet ishin dy llojesh - të ngulëta dhe të lëvizshme (ambulante). Spitalet ambulante lëviznin me kafshë ngarkese. Ato ishin të pajisur me barna, instrumente, tenda etj. Personeli i mjekëve dhe i infermierëve ishte njëlloj si ai i spitaleve të palëvizshme. Spitalet ambulante u shërbenin invalidëve, atyre që ishin të pamundur dhe atyre që banonin në zona të largëta. Këto spitale përdoreshin, gjithashtu, për të burgosurit, por edhe për publikun e përgjithshëm, sidomos në rast epidemie.

Bakteriologjia: Al - Raziu bëri përshkrimin e parë mjekësor të lisë dhe të fruthit - dy sëmundje të rëndësishme infektive. Ai e përshkroi dallimin klinik midis këtyre dy sëmundjeve kaq qartë, sa asgjë tjetër nuk është shtuar më për të që atëherë. Ibn Sina sugjeroi natyrën përhapëse të turbekulozit. Thuhet se ai ka qenë i pari që ka përshkruar mënyrën e përgatitjes së acidit sulfurik dhe të alkoolit dhe vetitë e tyre. Rekomandimi i tij për verën, si mjekuesi më i mirë i plagëve, ka qenë shumë i përhapur në praktikën mesjetare. Al - Raziu që i pari që përdori qepjet me mëndafsh dhe alkoolin për ndalimin e gjakrrjedhjes. Ai qe, gjithashtu, i pari që përdori alkoolin si antiseptik (bar që pengon shumimin dhe zhvillimin e mikrobeve).

# Le të shikojë njeriu, nga se është krijuar



Kur diskutohet për besimin në Zot, shumë njerëz (të thjeshtë apo të arsimuar) kërkojnë "çudira" të çastit, jashtë kornizës së njohurive të tyre. Kështu, lindja në tokën palestineze e një qengji, në lëkurën e të cilit gjendej e shkruar në arabisht "Zoti është më i madhi", u shoqërua me diskutime dhe qëndrime të ndryshme nga shtresa të ndryshme të shoqërisë.

Dikush shumë singerisht lavdëroi Zotin, duke njohur vullën e Krijuesit në këtë krijesë të re. Dikush heshti, duke dyshuar në vetvete. Dikush nuk besoi, duke iu bindur formimit të tij ateist.

Vërtet, fakte të tilla nuk janë të rastësishme. Ato kanë rëndësinë e tyre. Por, për dikë që mendon për botën rreth e qark tij, ka një pafundësi argumentesh që dëshmojnë Krijuesin.

Pa u hallakatur shumë rreth e rrotull, të vështrojmë përciptazi trupin tonë.

Filozofët e hershëm me të drejtë kanë shkruar se "kush njeh vetveten, njeh Krijuesin". Ndërsa një dijetar bashkëkohor shton: "Detyra e parë dhe numër një e çdo njeriu është të zbulojë e të njohë vetveten dhe, në sajë të këtij zhvillimi cilësor, të orientohet nga Zoti i vet. Fatkeqësit, që nuk e njohin veten, pra, s'e dinë se ç'janë, për çka edhe nuk mundën të krijojnë lidhje me Krijuesin e Lartë, jetojnë si hamej që bartin, por nuk dinë se ç'bartin dhe, po ashtu si ata, ikin nga kjo botë pa kuptuar gjë!"

Së pari, duhet të pranojmë që askush prej nesh (domethënë vetë qenia njerëzore) nuk e ka zgjedhur, apo akoma më tej, të ketë krijuar vetë kohën e ardhjes në jetë, formën fizike të tij, ndërtimin e organizmit dhe funksionimin e tij. Po ashtu, njeriu fizikisht (mish-kocka+gjak) të duket shumë i thjeshtë: një njeri me trup normal përmban aq yndyrë sa për të prodhuar 7 sapunë; sheqer, sa për të mbushur një kavanoz

mesatar; karbon, sa për prodhuar 9000 lapsa; fosfor, sa për të prodhuar 2200 fije shkrepe; hekur, sa për të bërë një gozhdë 2.5 cm; përmban një lugë sqfur dhe afërsisht 30 gramë metale të tjera.

Nga një përbërje shumë e thjeshtë (me sasi shumë të pakta lëndësh) është ndërtuar dhe funksionon në harmoni të mrekullueshme një organizëm i tërë. Ky është një argument i fortë që të bën të pranosh pa hezitim dhe përulje Krijuesin dhe madhështinë e Tij. Në të vërtetë, a nuk e lavdërojmë dhe pranojmë zotësinë e kuzhinierit, kur ai me pak asortimente gatuan një ushqim të shijshëm? A nuk habitemi me aftësitë inteligjente të inxhinierëve që televizorin, makinën llogaritëse, apo kompjuterët me llamba i transformuan në objekte shumë të vegjël (si në orë, telefona celulare etj.), që kërkojnë shumë më pak materiale? Pa dyshim që po. Atëherë, ngjashëm me këto, duhet të besojmë dhe lavdërojmë Allahun, Krijues, Formëdhënës, Udhëzues. "I Cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi. Të formësoi në formën që Ai dëshiroi." (Kur'ani, 82:7-8); që me diçka të pavlerë, bëri njeriun, këtë "makinë mishi e kockash" të mahnitshme. "Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur." (Kur'ani, 95:4). Shkenca që mësojmë në shkollë, pikërisht këtë pohon. Ndërsa nga ne pritët që të falënderojmë Allahun dhe ta adhurojmë Atë.

Organizmi ynë përbëhet nga 10(16) qeliza. Një qelizë përmban 10(12)-10(14). Vetëm truri, që përfaqëson 2% të peshës së përgjithshme të trupit, ka 12 miliardë qeliza nervore. Nëse këto do të renditeshin njëra pas tjetrës, do të krijohej një varg që do të arrinte deri në Hënë.

Gjithashtu, sasia e informacionit të mbartur në qelizë ia kalon fondit të informacionit të kompjuterëve më të mirë të prodhuar ndonjëherë. Cili është vëllimi i këtij informacioni?

Dihet që informacioni gjenetik i qelizës është shifruar në





renditjen e bazave të ADN-së.

Gjatësia e përgjithshme e të gjitha molekulave të ADN-së që gjenden në 46 kromozomet e qelizës arrin pothuaj 2 m. Në qoftë se këtu do të ishin koduar jo aminoacidet, por shkronjat e alfabetit, atëherë ADN-ja e një qelize të vetme do të mjaftonte për të koduar rreth 1000 vëllime të plota. Në qoftë se të gjitha ADN-të që ndodhen në organizmin e njeriut, do të çmbështilleshin dhe do të lidheshin pas njëri-tjetrit, ato do të formonin një varg të gjatë që do të përshkonte tërë sistemin diellor. Këtu nuk ka kurrsesi rastësi. Me urdhrin e Allahut, të Gjithëfuqishmit, asgjëja bëhet diçka, e thjeshta fiton përsosmëri. "Ai është Njohës i të fshehtës dhe i të dukshmes, i Gjithëfuqishmi, Mëshirëbërësi. Ai që përsosi krijimin e çdo sendi e, krijimin e njeriut e filloi nga balta. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët. Mandej, Ai e formëson atë (në barkun e nënës) dhe nga ana e vet i jep shpirt atij dhe, Ai është që juve ju pajis edhe me dëgjim, me të parit e me zemër. E pak send është ajo që ju falënderoni." (Kur'ani, 32:6-9)

Njeriu, me gjithë kompleksitetin e vet (me zemrën, mëlçinë, mushkëritë, sistemin nervor, muskujt etj.), e fillon jetën e tij nga një qelizë e vetme - qeliza vezë e pllenuar.

Por, si ndodh që nga një qelizë e vetme të lindë struktura e secilit organ, të zhvillohen organet funksionale (të ndërtuara nga shumë qeliza) për të formuar organizmin?

Embriologët akoma vazhdojnë të kërkojnë përgjigje për këtë pyetje. Ata thjesht konstatojnë këto fakte: Fati i qelizës përcaktohet në etapën e hershme të jetës embrionale.

Pak pas përcaktimit të rolit të ardhshëm të qelizës, kjo qelizë apo pasardhësit e saj fillojnë të përgatiten për kryerjen e funksionit të tyre. Çdo qelizë sintetizon proteinat që duhen për kryerjen e detyrës, rriten, ndahen dhe grupohen për të

formuar përfundimisht organin. Embriologët kanë konstatuar se ky proces kryhet me një përpikëri të pabesueshme. Dhe më tej: në trupin e njeriut çdo minutë vdesin 300 milionë qeliza; në qoftë se organizmi nuk do t'i zëvendësonte në mënyrë të vazhdueshme ato, të gjitha qelizat e trupit do të vdisnin për 230 ditë.

Përballë këtyre argumenteve, çdo inxhinier duhet të dorëzohet dhe të pranojë që roboti-hekur (që ai me shumë përpjekje ka mundur të prodhojë) është si grimca e rërës ndaj shkretëtirës kundrejt njeriut. Kemi parë nëpër ekspozita ku promovohen shpikje të njerëzve inteligjentë. Ndër to kemi parë robotë, që përmes telekomandave, vallëzojnë apo bëjnë ushtrime gjimnastikore. Por ata nuk mund të rriten vetvetiu. Ata ndryshken po të mos u bëhen shërbimet e duhura. Ne, qeniet njerëzore-spektatorë, habitemi dhe shprehemi me fjalët më të mira e lëvdata ndaj inxhinierëve "shpikës", kurse vetë inxhinierët ndjehen krenarë për veprat e tyre. Çfarë paradoksi në të menduar! Ne, çdo çast, çdo minutë, çdo orë e çdo ditë jetojmë me veten tonë, nga një qelizë e vetme jemi gatuar, rritemi, rinohe mi e plakemi, ndryshojmë, shëndoshemi apo dobësohemi dhe nuk mahnitemi me robotin-njeri (që ka mbi 60% ujë) e, më tej, nuk lavdërojmë e të shprehim mirënjohje për Krijuesin, të Gjithëmëshirshmin. Ky është një dallim cilësor që inxhinierët nuk mund ta kalojnë kurrsesi. Atyre, e së bashku me ta secili prej nesh, s'u mbetet gjë tjetër gjë veçse të pohojnë bindjen ndaj Allahut, të Vetmit, që jep jetë. Sa qartë dhe bukur e shpreh (para rreth 1400 vjetësh) Zoti në Kur'an këtë cilësi: "Ai është që ju krijoi ju prej dheu, pastaj prej një pike uji, pastaj prej gjaku të ngjizur, mandej ju bën të lindeni si foshnje e më vonë të arrini pjekurinë, e pastaj të plakeni..." (Gafir: 67).

*Dora që tund djepin do të rrisë  
**besimtarët e së ardhmes***

Islami u ka kushtuar rëndësi të madhe fëmijëve, sepse ata janë guri i parë i themelit të shoqërisë. Kjo fillon qysh para krijimit të fëmijës me zgjedhjen e një bashkëshorteje të mirë dhe të devotshme, më pas vijon me lutjen për mbrojtjen nga shejtani i mallkuar, që ai të mos ketë pjesë të fëmija. Kur fëmija vjen në jetë, tradita e Profetit tonë a.s. na mëson që t'i thirret ezani me zë të butë në vesh, në mënyrë që djalli të largohet prej tij dhe le të jenë fjalët e shehadeetit fjalët e para që ai do të dëgjojë në këtë botë. Më tej, në ditën e 7-të vënia e një emri të mirë, qethja e flokëve dhe bërja kurban; ku secila ka urtësinë dhe dobinë e vet.

Më pas ky kujdes i Allahut të Madhëruar shfaqet në afatin kohor të gjidhënies, që zgjat dy vite të plota. Kërkimet e fundit shkencore kanë vërtetuar se afati i gjidhënies për dy vjet, i përshkruar në Kur'an, është domosdoshmëri për rritjen e fëmijës në formën më të mirë. Ajo është mburojë fizike dhe psikologjike. Në fazën e gjidhënies hidhen themelet e karakterit. Nëse këto themele janë të qëndrueshme, në të ardhmen do të rriten breza të fortë, të shëndetshëm fizikisht dhe psikikisht. Në të kundërt, do të kemi të bëjmë me njerëz të dobët, të pavendosur, të pasigurt dhe të lëkundur përballë stuhive të sprovave. Një eksperiment çnjerëzor i kryer nga Frederiku i Dytë (1194-1250), tregon rrjedhojat fatale të mungesës së dashurisë dhe ngrohtësisë së nënës. Ai mori një numër fëmijësh dhe ua dorëzoi disa kujdestarëve, duke i urdhëruar që t'i ushqenin mirë, por të mos i flisnin absolutisht asnjë fjalë dhe të mos u jepej as dashuri e as ngrohtësi. Fundi i eksperimentit solli vdekjen e të gjithë fëmijëve.

Dashuria, butësia, dhembshuria dhe kujdesi i nënës janë të pazëvendësueshëm. Nëna është ajo që luan rolin kryesor në përkujdesjen ndaj fëmijës, sepse është krijesa më e afërt për të. Ajo është krijesa që më së shumti ndjen mëshirë, keqardhje dhe bën më shumë durim në edukimin e tij.

Rëndësia që u kushtohet fëmijëve në Islam shfaqet edhe në lutjet për ta. Duatë e Ibrahimit janë nga më të bukurat: "Zoti im, bëji të mirë pasardhësit e mi!" (Ahkaf, 15)

"Zoti ynë, na bëj ne të dy (Ibrahimin dhe Ismailin) dhe pasardhësit tanë prej besimtarëve të Tu të singertë!" (Bekare, 128)

Sipas Islamit, çdo njeri është një qenie e rëndësishme me një mision tepër madhor,

udhëheqjen në tokë. Ai është operatori, manovruesi dhe drejtuesi kryesor i kësaj toke. Ai është më i miri dhe më i zgjedhuri ndër krijesat e botës.

Po ashtu Suneti i Dërguarit a.s., i kushton rëndësi të madhe edukimit të fëmijëve. Le të hedhim një vështrim të shkurtër në të.

Një hadith që e shfaq më së miri rëndësinë e edukimit të fëmijëve është:

"Edukimi i fëmijës fillon 20 vjet para lindjes së tij". Ky hadith është vërtetuar edhe nga pedagogjia moderne. Duke pasur parasysh këtë thënie, le të shohim përgatitjen tonë dhe le të marrim mësim nga më i miri i njerëzve, Profeti ynë a.s. Transmetohet nga Abdullah Ibn Amir se ka thënë: "Kur isha i vogël na erdhi Profeti a.s. në shtëpi. Dola për të luajtur dhe nëna më tha: "O Abdullah, eja të të jap diçka. Profeti a.s. iu drejtua asaj: "Çfarë deshe t'i japësh? Nëna ia ktheu: "Një hurmë." Atëherë ai i tha: "Nëse nuk do t'ia jepje hurmën, do të të regjistrohej si gënjeshtër."

Ndërsa nga Abdullah ibni Mes'udi përcillet se Profeti a.s. ka thënë: "Nuk duhet që njeriu t'i premtojë fëmijës e pastaj ta shkelë premtimin". Me këto fjalë, ai ka vënë bazën e edukimit që është sinqeriteti dhe vërtetësia në çdo gjë.

Fëmijët kanë nevojë për modele dhe prindërit janë modeli i tyre i parë. Me qëllim që të jenë vetë shembuj të mirë, ata kanë nevojë që të kenë parasysh gjithmonë modelin e tyre që ta ndjekin. Për prindërit myslimanë, Profeti Muhamed është modeli ideal që duhet të ndiqet. Edukimi më i mirë mund të arrihet vetëm nga një prind, personaliteti i të cilit, nga forca e moralit, të shkaktojë admirim të fëmija.

Njeriu është mëkëmbësi i Allahut në tokë dhe për edukimin e tij duhet të plotësojmë dy kushte të rëndësishme:

- Aktivizimin e dhuntive natyrore pozitive me të cilat fëmija është i pajisur që nga lindja.

- Largimin e prirjeve të devijuara si dhe dhuntive shkatërruese të cilat nuk i korrespondojnë moralit të bukur islam.

Profeti Muhamed a.s. ka thënë: "Çdo njeri lind në gjendje natyrore të pastër islame. Prindërit e tij më vonë e bëjnë idhujtar apo të ndonjë besimi tjetër."

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an:

"Përqendro veten tënde sinqerisht në fe i larguar prej çdo kotësie, feja e Allahut sipas të cilës i krijoi njerëzit. Ajo është feja e drejtë,



por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Rrum, 30)

Me ajetin dhe hadithin më lart, kuptojmë se fëmija lind i mirë dhe i pastër nga natyra. Detyrë e prindërve është ta ruajnë këtë karakter dallues me të cilin Allahu i ka krijuar fëmijët.

Pika e tretë dhe më e rëndësishmja është mëshira. Le t'i kthehemi shembullit të Profetit tonë, i cili porositi: “Kush nuk është i butë dhe i mëshirshëm me të vegjlit dhe nuk mëshiron më të vjetrit nuk është prej nesh.” Nga Ebu Hurejra transmetohet se Profeti e puthi nipin e tij Hasanin, ndërsa Ekra bin Habis et-Temimi ishte ulur pranë tij. Ai i tha: “Unë kam 10 fëmijë dhe asnjëherë nuk kam puthur ndonjë prej tyre. I Dërguari i Allahut e vështroi dhe i tha: “Kush nuk është i mëshirshëm me të tjerët nuk do të tregohet mëshirë për të.”

Një tjetër aspekt është butësia. Profeti a.s. ka thënë: “Allahu është i butë dhe e do butësinë. Shpërblimin që Ai jep për butësinë nuk e jep për ashpërsinë. Atë shpërblim Ai nuk e jep për asgjë tjetër.”

Fëmijët janë amanet nga Allahu për të cilët do të pyetemi. Profeti Muhamed a.s. thotë: “Çdo bari është përgjegjës për tufën e tij. Gruaja është përgjegjëse për fëmijët dhe shtëpinë.”

Dhe një nga detyrat ndërmjet shumë detyrave të tjera që i takojnë nënës, është t'u mësojë fëmijëve të saj besimin islam. Që në fëmijërinë e hershme fillohet duke e njohur fëmijën me emrin e Allahut. Më pas, atij i paraqiten argumentet e krijimit të Allahut në natyrë, duke i thënë se gjithçka është e krijuar prej Tij. Fëmijët e vegjël duhet të njihen me emrat dhe cilësitë e Allahut. Kjo do t'u japë atyre siguri dhe mbrojtje. T'ua vëmë në dukje sjelljen e mirë dhe të mos theksojmë vetëm sjelljen e keqe. Një nga aspektet më të rëndësishme është

shfaqja e idesë se Allahu është i kënaqur me veprimet e tyre. Kështu, ata do të mësohen të lidhin sjelljen e mirë me kryerjen e diçkaje për hir të Allahut.

Theksimi i negatives dhe i ndëshkimit, e bën fëmijën të shmangë çdo gjë që ka lidhje me fenë. Çdo aspekt i jetës së përditshme mund të shoqërohet me komente të shkurtra që vënë në dukje ngjyrimin islam.

Me rritjen e fëmijës, prindërit duhet t'i përgjigjen pyetjeve të tij që lidhen me besimin pa harruar t'i sugjerohet atij shikimi dhe të menduarit mbi krijimin e gjithësisë.

Profeti a.s. thotë: “Në moshën 7 vjeç mësojini namazin...” Këshilla mjaft të çmuara për ne janë këshillat e Llukmanit a.s. drejtuar djalit të tij: “Biri im, mos i përshkruaj shok Allahut se idhujtaria është padrejtësia më e madhe.”

Kur fëmijët arrijnë adoleshencën fillojnë të pyesin për atë që u është mësuar. Nëse ju tashmë keni krijuar një marrëdhënie të mirë me ta, fëmijët do t'ju drejtohen për pyetjet dhe shqetësimet e tyre. Në këtë kohë, prindërve u takon t'i mbështesin, të diskutojnë me ta dhe të jenë të hapur. Pasi të kenë dalë nga periudha shqetësuese dhe plot pikëpyetje e adoleshencës, ata do të jenë me lejen e Zotit, të rinj që kanë përqafuar Islamin aktivisht.

Së fundmi, detyra e nënës është ndërtimi i vetëvlerësimit të fëmijës, në mënyrë që ai të ndjejë se është dhuratë e veçantë prej Allahut. Dihet se rruga e vështirë e edukimit të fëmijëve iu hap përpara horizontin e gjerë dhe të bukur të dijes. Kapuni për dore me fëmijën sepse edhe ju tashmë jeni në një proces nxënieje të vazhdueshme dhe ç'është më e rëndësishme, kërkojeni ndihmën dhe udhëzimin e Allahut, sepse dora që tund djepin, do të rrisë besimtarët e së ardhmes.



# ***Fetaria*** **formale**



Një proverb popullor, duke dashur të përshkruajë atë që kryen pesë faljet, por megjithëkëtë shkel të drejtën pronësore të tjetrit dhe përvetëson paligjshëm pjesë të saj, thotë: "I fal farzet (namazet e obliguara) dhe rrëmih tokën."

Ky proverb popullor kritikon fetarizmin formal dhe të shtirur, në të cilin njeriu mjaftohet me kryerjen e ritualeve formale, ndërsa braktis vlerat dhe tiparet morale, të cilat janë objektivat e vërteta të adhurimeve dhe shpirti i vërtetë i ritualeve islame.

Kredoja islame nuk është thjesht vetëm të dëshmosh deklaratën (shehadetin), sepse deklarata 'La ilahe il-laAll-llah Muhammedun Resulullah' është titulli i kësaj kredoje dhe shembulli i saj i ngjan shembullit të librit, që njihet nga titulli, por jo gjithçka thuhet në të ose e tërë përmbajtja e librit tkurret në të (titull). Islami është ngritur mbi pesë detyrimet kryesore: shehadetin (deklaratën), namazin, zekatin, agjërimin dhe haxhin, por këto nuk janë tërë Islami. Ato janë bazat e godinës gjigante, të cilën e përfaqëson Islami, sepse Islami nuk plotësohet pa godinën, ashtu siç edhe kjo e fundit nuk mund të ngrihet pa themele.

Të gjitha detyrimet (farzet) e Islamit kanë qëllime dhe objektiva të çiltra dhe etike, të cilat sillen rreth pastërtisë shpirtërore dhe ndershmërisë, mirësisë, besnikërisë, mirëqenies dhe prosperitetit familjar, shoqëror e shtetëror, gjëra këto që ruhen falë vlerave të larta e fisnike që solli Islami. Përkitazi me këtë të vërtetë, të vërtetën se Islami është program i plotësuar dhe i përsosur i jetës, në Kur'an thuhet:

"Thuaj: "Në të vërtetë, namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij"" (En'amë, 162-163)

Myslimani nuk është si materialisti "zotëri i gjithësisë". Ai është mëkëmbës i Zotit të Lartëmadhëruar në tokë, i Cili është Zoti dhe Zotëruesi i kësaj gjithësie. Për këtë shkak, të gjitha veprimet e mysliamanit, qoftë si individ, qoftë si shoqëri, janë veprime të atij që është i ngarkuar, përfaqësues, i autorizuar, i detyruar t'i përmbahet kontratës së mëkëmbjes, respektivisht ligjit (shariatit) të Allahut, i Cili ka dërguar profetë me program të qartë, i

cili duhet ndjekur e përfillur në këtë jetë.

Myslimani është i lirë dhe me mundësi të zgjedhë, por liria e tij është brenda kornizave të programit hyjnor; atij nuk i lejohet ta lejojë të ndaluarën (haramin) dhe as ta ndalojë të lejuarën (hallallin), ndërsa robëria e tij për Allahun është maja e lirisë dhe çlirimit të tij nga të gjithë tiranët e dynjasë. Ai, shprehur sipas Muhamed Abdo-s, është 'vetëm rob i Zotit e pastaj zotëri i çdo gjëje tjetër (në këtë planet)'.

Interesi, që në shoqëritë materialiste sponsorizon (vendos për) miratimin e ligjeve, është thjesht vetëm interes, përderisa në vizionin islam është interes fetarisht i pranuar dhe i aprovuar. Së këndejmi, për të përcaktuar përmbajtjen e interesit dhe kriteret e tij, patjetër duhet që norma të asociojë (bashkëveprojë, lidhet) me mendjen (arsyen), ndryshe, shoqëritë që përjashtojnë normën nga arsyeja, vetëm interesin material e shohin si kriter të interesit. Si shembull konkret mund të marrësh trellojet më fitimprurëse të tregtisë në shoqëritë kapitaliste: tregtia e armëve, prostitucionit dhe lëndëve narkotike. Dobia apo përfitimi i kënaqësisë (apo dëfrimit dhe zbavitjes) mund të realizohet me shumë gjëra të ndaluara, në mesin e të cilave edhe dehja dhe homoseksualizmi, por cilat janë kënaqësi e dobi të ndaluara për ata që i përmbahen programit islam.

Për hir të kësaj të vërtete, që e bën të veçantë kredon islame, besimi nuk është reduktuar vetëm me shqiptimin formal të deklaratës 'La ilahe il-laAll-llah Muhammedun Resulullah'. Jo, besimi është godinë e përsosur, e lartë dhe universale, të cilën e shpreh kuptimisht hadithi profetik: "Besimi është shtatëdhjetë e ca degë, nga të cilat më e larta është La ilahe il-laAll-llah, ndërsa më e ulëta është heqja e pengesës nga rruga."

Adhurimet islame nuk janë thjesht rituale, ato janë mjete për qëllime të cilat me sistem vlerash dhe morali pastrojnë shpirtin. Ndërsa ata që mjaftohen në fe me rituale formale, nuk do të përfitojnë gjë prej tyre. Ka agjërues që nga agjërimi i tij nuk përfiton asgjë, me përjashtim të urisë dhe etjes. Kurse atë që namazi nuk e largon nga të këqijat, ai nuk do të ndalë së larguari prej Allahut.

# RRUGË TJETËR, NDJEKJE E VËSHTIRË





Profeti ynë i dashur me shokun e tij të mirë, Ebu Bekrin, ishin nisur për në Medinë. Por nuk do të shkonin nga rruga e zakonshme. Ata do të ndiqnin një rrugë tjetër. Të gjithë mendjeprishurit që donin të fitonin njëqind deve kishin dalë për t'i kërkuar këta dy udhëtarë të bekuar. Por në çdo rrugë që ndiqnin ktheheshin duarbosh. Sakaq, një grup prej tyre e kishte hamendësuar rrugën që mund të ndiqte Profeti a.s.

Një ekip i armatosur e me kuaj e kishin gjetur rrugën që mund të kishte ndjekur Profeti bashkë me Ebu Bekrin besnik. Dy shokët e bekuar u fshehën në shpellën Theur. Mosbesimtarët, që kishin mbërritur deri në hyrjen e shpellës, thanë:

- Ejani shpejt. Këtu përfundojnë gjurmët. Ata duhet të jenë këtu. S'ka mundësi të kenë vazhduar më tej.

Të gjithë u mblodhën të gëzuar përpara shpellës, mirëpo një merimangë kishte thurur një rrjetë të stërmadhe në hyrje të shpellës. Një rrjetë që ishte me shumë shtresa, ndërsa aty pranë ishte një pëllumb që kishte shtruar vezët e tij të sapolindura. Nga brenda shpellës dukeshin vetëm trupat mes e poshtë të mosbesimtarëve të armatosur. Nëse ata do të përkuleshin për të parë brenda shpellës, do ta vinin re Profetin e Allahut me shokun e tij.

Ebu Bekri, i frikësuar jo për veten, por se mos i ndodhte gjë Profetit, iu drejtua atij me këto fjalë:

- Nën dhe babai im të qofshin falë o i Dërguar i Allahut. Nuk dua t'ia di se ç'mund të më ndodhë mua, por kam frikë se këta njerëz të këqij mund të të bëjnë keq ty.

Profeti ynë ia ktheu me qetësi:

- Mos u tremb o Ebu Bekr. Allahu është me ne.

Jashtë shpellës po bëheshin biseda të nxehta. Njëri prej mosbesimtarëve tha:

- Për mendimin tim, jemi duke humbur kohë kot. Nëse Muhamedi do të ishte këtu, bashkë me shokun e tij, kjo rrjetë e merimangës do të ishte prishur.

- Po, ke të drejtë. Kjo rrjetë do të ishte prishur dhe ky pëllumb do të kishte fluturuar, - u hodh një tjetër. - Për mendimin tim, kjo rrjetë është thurur shumë kohë para se të lindte edhe vetë Muhamedi, prandaj ejani të mos humbasim më shumë kohë.

Profeti dhe shoku i tij pritën plot tri ditë në shpellë. Në këto tri ditë mosbesimtarët nuk lanë cep pa kërkuar. Ditën e tretë në agim, njëri prej robërve të Ebu Bekrit u solli atyre dy deve. Kështu nisi udhëtimi që do të mbaronte në Medinë.

Mirëpo nuk kishte kaluar as gjysma e rrugës, kur Suraka, një mosbesimtar nga Meka, ra në gjurmët e tyre. I kishte arritur duke e ngarë kalin me galop ditë e natë. Ebu Bekri besnik u shqetësua shumë kur pa se dikush po i ndiqte. Profeti iu drejtua përsëri shokut të tij me këto fjalë:

- Mos u tremb o Ebu Bekr. Allahu është me ne.

Pastaj u kthye për të parë nga Suraka. Sapo e pa Profetin, këmbët e kalit të Surakës filluan të zhyteshin në tokë

duke e ndaluar kalin që të lëvizte. Kur Profeti u kthye që të vazhdonte rrugën, kalit iu çliruan këmbët prej rërës. Sakaq Suraka vazhdoi t'i ndiqte. Profeti u kthye për ta parë dhe këmbët e kalit filluan të zhyteshin sërish në tokë. Sikur të mos mjaftonte kjo, nga vendi ku ishin zhytur këmbët e kalit filloi të dilte tym. Suraka e kuptoi se kjo ishte një mrekulli e Allahut dhe iu drejtua Profetit të Allahut:

- O Muhamed! Mos më lër këtu. Ti je më i mëshirshmi ndër të gjithë ne. E kuptova se këto që po më ndodhin vijnë ngaqë po të ndjek ty.

Profeti a.s. iu përgjigj:

- Të shpëtoj, por vetëm me një kusht.

- Thuaje o Muhamed, jam gati ta pranoj.

- Tani do të reshtësh së na ndjekuri dhe do të kthehesh mbrapa. Nëse ka të tjerë që janë duke ardhur në këtë drejtim, do t'i ndalosh, në rregull.

- Në rregull. Do ta bëj atë që më thua. Vetëm më shpëtoj prej kësaj gjendjeje.

Teksa po zhvillohej kjo bisedë, kali i Surakës u çlirua prej tokës, dhe ai e mbajti fjalën duke u kthyer për në Mekë. Rrugës ai pa të tjerë që i qenë vënë pas të Dërguarit të Allahut. Duke i treguar atyre rrugën se nga kishte ecur Profeti, u tha:

- Këto anë i shëtita unë të tëra. Prej andej po vij. Nuk ka njeri që të jetë duke udhëtuar në këto anë. Hajdeni ta kërkojmë Muhamedin në drejtime të tjera.

Mekasit ndërruan rrugën duke falënderuar Surakën për ndihmën e dhënë. Kështu që tashmë nuk kishte më njeri që ta ndiqte Profetin nga pas. Në Medinë të gjithë ishin duke pritur me shumë emocion mbërritjen e Profetit dhe shokut të tij. Njerëzit vinin çdo ditë deri në të dalë të qytetit të Medinës, derisa dielli bëhej gati për të perënduar, për të pritur këta dy miq të bekuar. Profeti i Allahut nuk kishte mbërritur ende, megjithëse koha e mjaftueshme për të mbërritur nga Meka kishte kaluar. Medinasit merakoseshin shumë se mos i kishte ndodhur ndonjë gjë rrugës. Ata dilnin të gjithë në rrugë, me fëmijë e pleq, gra e burra, për të pritur Mbretin e Profetëve. Gratë rrinin nëpër çatitë e shtëpive, djemtë e rinj hipnin mbi pemët e hurmave për të parë sa më larg prej andej nga pritej të mbërrinte Profeti i Nderuar. Më në fund, një nga djelmoshat që qëndronin mbi pemët e hurmave, lajmëroi:

- Po vijnë. Po vijnë. Erdhën, ja ku janë.

Pas këtij sihariqi, i gjithë populli i Medinës u derdh nëpër rrugë. Edhe fëmijët e vegjël që gjendeshin në krahët e nënave të tyre, nisën të vraponin për të pritur Profetin e profetëve, bashkë me shokun e tij besnik, Ebu Bekrin. Fëmijët vraponin duke lodruar. Të rinj e të vjetër derdhnin lot gëzimi. Në gojë të tyre kishte këngë, ndërsa në fytyrat e tyre gëzim të papërshkrueshëm. Asnjëherë në rruzullin tokësor nuk ishte pritur dikush në këtë lloj mënyre.



# Shpirti i Dëshmorit

Me të ngrysur, djelli verdhët, perëndon,  
Hidhërimi i ndarjes shpirtin ja lëndon,  
Plakos errësira, shtohet dhe rëndon,  
Një hije e zezë të ndjek, të mundon,  
Si mortja e murmë me turi të zi,  
Drurët dhe gurët i ndan po me zi.

Ferrat, drurët, gurët në këmbë ngritur,  
Sikur të katisin dyk e trapitur,  
Llahtari e madhe për të çuditur,  
Shih në mest të hijes një sent të ndritur,  
Me çkëlqim të bukur nga të vërtitur,  
Ky është dëshmori q'u vra si duhet,  
Në fletët e nalta ky dëshmor quhet,  
Emr' i tij në botët kurrë nuk shuhet.

Jak ku e ka varrin pranë shëntit plak,  
Edhe sot nga plagët e tij ecën gjak,  
Mos ki frikë! Mblidhu! Qëndro këtu pak,  
Është shpirt i mirë, ri! Mos ki merak,  
Frikën, llahtarinë nga zemra e flak,  
Me qefin në krye është mos u tremp?  
Kjo e shkretë kaqë nuk di pse të dhemp?  
Ka vdekur Profeti bota nuk u shemp.

Veri vesh sa fjalë të nalta po flet,  
Shpirt-naltë, i ndyer Dëshmor me vërtet,  
Ra victim në Durrës për Atdhen' e vet,  
Fluturon si zogu në Parajs me flet,  
Bashkë me shehidët që ka n'atë jet,  
Thotë: jam i gjallë, unë nuk kam vdek,  
Për Atdhen' e dashur, unë jam përpjek,  
Tani, me gjith shokët në Parajs jam pjek.

Marrë prej librit "Kujtimet e Burgut"  
hte as mjaltë.





KONFERENCË

## IHTIJARI DHE ROLI I TIJ NË MENDIMIN JURIDIK ISLAM

13 | 12 | 25

ME RASTIN E BOTIMIT TË KOLANËS  
“EL-IHTIJARU LI TA’LILI-L-MUHTARI”



📍 TIRANA INTERNATIONAL HOTEL

🕒 ORA 10:00